# PREKJA E PIKËLLIMIT
## Monografi, poezi dhe përkujtime

Biblioteka
Monografi-Kujtime

Redaktor
Xheladin MJEKU

Recensentë
Halil XANI
Agim METBALA
Xheladin HAMZA

Lektor
Halil XANI

Dizajni&Realizimi kompjuterik
Besmirë BYTYÇI

Kopertina&Albumi
Egzon Xh. MJEKU

Botues:
SHB "OLYMP" – Prishtinë, 2013

# PREKJA E PIKËLLIMIT

Monografi,
poezi dhe përkujtime

Përgatitur nga:
Xheladin Mjeku
&
Halil Xani

Prishtinë, 2013

**XHELADIN MJEKU**

# PREKJA E PIKËLLIMIT

*Adem Berishës - Gjurgjeviku*

Sot erdha të të takoja  atje
Takova dhimbjen
Edhe fjalët kishin tretur
Deri në pikën e heshtjes

Preka pikëllimin
Vrushkuj malli përvëlonin shpirtërat
E lotonte qyteti i heshtur
Njerëzit shikoheshin në pasqyrën e dhembjes
Qiellit mundimshëm ia shqyenin mjegullën
Me ngjyra vjeshte mbuluar plot trishtim
Diellore binin si tufa argjendi
E vargje bëheshin përnjëmend
Pahetueshëm përftove shekullit tënd të dritës

Përballjet me thirrjet në kupë qielli
Nga Diellza që të digjte
A miqtë që të prisnin në maje vargu

Tashmë paske zgjedhur rrugën tënde
Që shpie kah pavdekësia

Sot erdha të bisedonim si kahera
Takova pikëllimin
E fjalët kishin fluturuar qiellit  me kaltri
Derisa ikja kishte marrur udhë
Me yjet të pash kur po u buzëqeshje
Në çastet e takimit me Diellzën që të ftonte
Në përqafimin e mallit
Baca Adem

*16.05.2012*

# MIQTË PËR MIKUN

Me dëshirën që të kryejmë një detyrë që befas na shtroi si obligim situata e krijuar, kur u dha kumti i zi se nuk frymon në mesin tonë miku dhe krijuesi i letrave shqipe, Adem Berisha, duke na lënë fjalën dhe veprën e tij prej krijuesi dhe veprimtari të shquar në çështjen kombëtare, një grup miqsh e bashkëveprimtarësh iu qasëm një pune jo edhe aq të lehtë për të përjetësuar veprimtarinë e tij, duke përmbushur një obligim që ndienim për këtë krijues të palodhshëm e shumë entuziast për moshën që kishte, që fati e deshi t'i ndërpritej aktiviteti i tij në gjysmërrugë.

Me të mësuar për ngjarjen, nuk pushuan shkrime e telefonata, për të ngushëlluar sekush mikun a shokun, familjen a bashkëveprimtarët që prej kohësh kishin bërë kontakte të shumta rreth bisedave për jetën, krijimtarinë dhe problemet jetësore e politike që ishin preokupime të tyre. Por, jo vetëm kaq, ata nuk hezituan që të hedhin idenë e ngritjes së një monumenti të përjetshëm prej fjalëve, vargjeve dhe mallit për mikun e tyre, që tashmë e kujtojnë për veprimtarinë e tij, për bujarinë dhe zemërgjerësinë prej fisniku. Idenë për një ndërmarrje të këtillë e hodhi Halil Xani, për ta mbështetur pastaj edhe të tjerët, si Xheladin Mjeku, Agim Metbala, Xheladin Hamza e deri tek miqtë nga diaspora që kontribuan në financimin e botimit të këtij libri të veçantë dhe të një rëndësie të shumëfishtë, kur kemi parasysh përfshirjen e materialeve që janë bërë këtu. Tashmë kjo inisiativë

përfundimisht po bëhet realitet, me nxjerrjen në dritë të këtij libri me shumë shkrime e dëshmi tjera, që në një mënyrë paraqet një monografi për autorin dhe, poashtu është edhe libër me përkushtime poetike e dëshmi me fotografi të ndryshme, ku dëshmohet se Adem Berisha ishte i afërt me miqtë dhe nuk hezitonte të gjendej në gëzime e hidhërime, në aktivitete kulturore e përurime librash, pavarësisht kohës dhe vendit ku zhvilloheshin ato.

Adem Berisha, ashtu sikur i bashkonte të gjithë miqtë në një kuvend mendimesh e idesh me urtinë dhe fjalën e ëmbël për të gjallë, ashtu i bashkoi këtu në këtë libër, me shkrimet përkujtimore dedikuar emrit dhe veprës së tij, për të mbetur përgjithmonë *Libri i dashurisë dhe dhimbjes* për mikun e tyre që i deshi dhe i respektoi në çdo kohë, poaq sa edhe miqtë, me konsideratën e tyre të pakursyer shprehën dhimbjen, mallin dhe krenarinë për mikun e tyre, që tashmë e kujtojnë në mënyrën më të bukur, duke sjellur evokimet dhe gjithçka kishin për të thënë e kujtuar për të në këtë përmbledhje shkrimesh e fotografish, si një bibliotekë dhe galeri nën të njëjtin kulm, të pagëzuar me emrin simbolik ‘Prekja e dhimbjes”, që flet bindshëm për frymën e mesazhin që përshkohet këtu.

U bashkuan miqtë dhe bënë një monument përkujtimor për mikun e tyre që aq shumë i deshi dhe e deshën deri në çastet e fundit të jetës, do të ishte konkludimi më i përafërt i kësaj që u tha dhe u bë për ndriçimin e emrit dhe veprës së Adem Berishës.

Nga Hartuesit e librit

# I
# JETA DHE VEPRIMTARIA

# ADEM BERISHA – GJURGJEVIKU (1948 – 2012)

## SHËNIME BIOGRAFIKE

Adem Berisha u lind më 03. 05. 1948, në fshatin Gjurgjevik i Madh të komunës së Klinës. Rrjedh nga një familje e njohur për nga ideali dhe përcaktimi kombëtar. Në fëmijërinë e tij të hershme përballet me varfërinë dhe ashtu në kushte tepër të vështira ekonomike, e si bonjak vijon mësimet e para në shkollën fillore "Zejnel

Hajdini” në Ujëmirë. Përveç në mësime, ai dallohet ndër nxënësit më të mirë të shkollës edhe në angazhimet e tij në shumë aktivitete letrare dhe kulturore që organizoheshin në shkollë. Falë këtyre shkathtësive Ademi arrin të bëhet njëkohësisht anëtar aktiv i grupeve letrare, dramatike dhe muzikore, që zhvillonin aktivitet në kuadër të shkollës. Pas përfundimit të shkollës fillore regjistrohet në shkollën e mësuesisë pranë normales “Hasan Prishtina” të Mitrovicës të cilën e kryen me sukses të shkëlqyeshëm. Gjatë kohës sa ishte në shkollim u detyrua të punojë si mësues nëpër fshatra të ndryshme të Dukagjinit, por asnjëherë nuk iu nda shkollimit, që ishte ëndërra dhe dëshira e tij e madhe, për ta realizuar mbarimin e shkollës me sukses të shkëlqyeshëm. Këto aftësi i hapin rrugë në ecjen përpara, duke shtrirë aktivitetet e tij në fushëveprimtari të shumta me karakter kombëtar për çlirim nga thundra shekullore e okupimit klasik dhe ushtrimit të masave gjenocidale.

Në fillim të karrierës së tij punoi si mësues nëpër fshatra malore si në Gorozhup të Hasit, Shkozë dhe Gurbardh të Malishevës, ndërsa që nga viti 1973, punon si punëtor i administratës komunale në komunën e Rahovecit.

Aktiviteti i tij shtrihet në fushëveprimtarinë letrare dhe në rrafshin politik, ku si frymëzues nga paraardhësit e tij, nuk rreshti së vepruari në ndihmën dhe përkrahjen e ndryshimeve politike, sidomos nga vitet tetëdhjetë të shekullit që lam pas e këtej. Këtë e dëshmojnë angazhimet e tij në forume e aktivitete politike e sindikale që kishte dhënë kontribute të mira. Ai ishte këmbëngulës në demaskimin e politikës diskriminuese antishqiptare të regjimit totalitar të periudhës millosheviqiane, ku u dallua për angazhimet e tij, sidomos në Këshillin nismëtar për themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për

regjionin e Rahovecit, për të vazhduar pastaj me aktivitete të tjera, si në Këshillin lokal për pajtimin e gjaqeve dhe së fundi angazhohet edhe në themelimin e Sindikatës së Pavarur të organeve të administratës dhe judikaturës së Rahovecit, prej nga delegohet dhe zgjedhet anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Degës së administratës dhe judikaturës qendrore të Kosovës. Këtu veçojmë Mirënjohjen që pak para ndarjes së tij nga jeta ia kishte ndarë kjo Sindikatë e që iu dorëzua familjes pas vdekjes së tij.

Më datën 15 maj të vitit 2012, në një aksident trafiku nuk mundi t'iu përballojë plagëve të rënda dhe përfundimisht u nda nga jeta për të lënë tri përmbledhje poetike të botuara dhe shumë dorëshkrime të cilat një ditë do t'i dhurohen lexuesit të tij që edhe deri më tash e kishin dashur dhe adhuruar fjalën e tij poetike dhe mesazhin që përcillte kjo poezi. Vdekja tragjike e gjet në vlugun e aktiviteteve të tij letrare, ku sapo kishte nxjerr nga shtypi librin e tij të tretë dhe po bëhej gati të bënte përurimin e tij me miq e adhurues të fjalës poetike.

Vlerat që ka krijimtaria e tij poetike dhe mendimi intelektual e komunikimi ndërnjerëzor me miq e adhurues të artit gjatë gjithë kohës, bëjnë që të radhitet në mesin e krijuesve që tërë mundin dhe jetën ia kushtuan çështjes kombëtare dhe lirisë së atdheut të tij - Kosovës, që parreshtur punoi gjatë tërë jetës, për t'i dhënë kështu tri përmbledhje me poezi. Opinioni artdashës mbetet i afërt, me shkrimet, publikimet e komentet për shumë tema e shkrime të miqëve e shokëve që bashkëvepronin prej vitesh, sidomos në rrugët elektronike që u bënë arenë kontaktesh e këmbimesh të përvojave të ndryshme nga gjithë vendet ku takoheshin pena e aktivitete krijuesish letrar.

Shkrimet e tij, kryesisht poezi, i botoi nëpër disa forume e faqe shqiptare të internetit, për t'i përmbledhur pastaj edhe në përmbledhjet poetike: **"Krenaria dhe pikëllimi"** (2007) dhe **"Lulja la lulishten"** (2010) dhe, vetëm pesëmbëdhjetë ditë para ikjes nga jeta, nxori përmbledhjen e tretë poetike "**Përballje**" (2012). Ai la në dorëshkrim shumë shkrime të pa publikuara. Në shenjë respekti dhe konsiderate për mikun e tij, shumë krijues e miq u bashkuan dhe nxorën edhe monografinë për jetën dhe veprimtarinë e tij, që ta kenë më të kompletuar kujtimin dhe njohuritë rreth veprimtarive të tij të shumëfishta.

**FETAH BERISHA**

# DISA FJALË PËR AUTORIN

Autori u lind më 03.05.1948, në fshatin Gjurgjevik të Madh të komunës së Klinës.

Rrjedh nga një familje e varfër fshatare por të pastër për nga ideali dhe përcaktimi kombëtar. I ati i autorit, Zeqë Ramadani, ishte kinse i mobilizuar si partizan në luftën e dytë botërore por në vend të kësaj përjetoi marshim famëkeq e për shumë kend edhe tragjik-atë drejtë masakrës së Tivarit të 1945-tës bashkë me disa bashkëfshatarë të tij si Jusuf Mangjolli, Prekë Martini, Tafil Bajrami e të tjerë. Kjo njësi pati fatin t'i shpëtonte masakrës së Tivarit si njësi plotësuese e arradhave partizane të Dalmacisë dhe Istrës e duke iu falënderuar disa oficerëve kroatë të cilët e tërhoqën drejt destinimit.

Në dimrin egër të 1947-tës bashkë me të vëllanë Rexhep Ramadanin dhe birin e vëllait Musë Rexhepin gjëndet i lidhur për kumbullat e Sali Gjokës për tri javë rresht, presion ky për të treguar se ku gjenden Ukë Sadiku, Halil Sadrija (biri i vëllait) dhe Qazim Bajraktari i Ostrozubit të cilët ishin pjestarë të organizatës patriotike të Ballit Kombëtar. Kjo zgjatë gjerë më 17.02.1947, kur kuislingët dhe shërbëtorët e armikut iu bien në gjurmë dhe i qesin në pritë në fshatin Sferkë të Gashit, në avlinë

e dhëndrrit të Ukë Sadikut – Sokol Dinit, me ç'rast vriten në vend Halil Sadrija e Qazim Bajraktari ndërsa Ukë Sadiku plagoset rëndë por arrin të largohet nga vendi i ngjarjes e më pas sipas kërkesës së prokurorit të atëhershëm, antishqiptarit famkeq Ali Shukrija, ekzekutohet në "Tauk Bahqe" të Prishtinës.

I ati i autorit, Zeqa vdes në moshën 40 vjeçare duke lënë pas të ëmën Shahen, bashkëshorten Fazilen, Ademin 6 vjeçar dhe Shabanin 1 vjeçar. Çka të flitet për jetën që pastaj kanë bërë këta bonjakë të cilët pas tri vitesh mbetën në përkujdesjen vetëm të nënës Fazile 32 vjeçare dhe e cila jetoi gjer më 17.02.2007.

Autori në kushte gati të pa para varfërie vazhdoi mësimet pranë shkollës fillore "Zenel Hajdini" në Ujëmirë dhe përkundër gjithë vështirësive, u dallua ndër nxënësit më të mirë të shkollës. Që atëherë ai ishte anëtar i grupit letrar të shkollës, atij dramatik dhe atij muzikor. Pas përfundimit të shkollës fillore me sukses të shkëlqyeshëm, u regjistrua në shkollën normale, atëherë "Silvira Tomazini" në Skenderaj si paralele e ndarë e normales së Mitrovicës e cila pas ardhjes së Ahmet Malokut për drejtor, ndërroi emrin në "Hasan Prishtina". Pas kryerjes së vitit të dytë, në vitin 1965, për shkak të kushteve tejet të vështira ekonomike detyrohet të ndërpresë shkollimin dhe të punojë si mësues i pakualifikuar nëpër fshatrat më të largëta si në Gorozhup të Hasit, Caravranë, tani Gurbardh të Malishevës, Millanoviq, tani Shkozë poashtu të Malishevës etj. Në vitin 1968, përsëri këthehet si nxënës i rregullt në klasën e III-të të normales në Mitrovicë në të cilin vit ndodhin demonstratat e nëntorit, të cilat përfshijnë pothuajse të gjitha qytetet e Kosovës e poashtu edhe Mitrovicën, bartës të të cilave ishin nxënësit e normales, ata të

gjimnazit dhe të shkollës teknike ndër të cilët edhe vetë autori i këtij libri. Edhe si normalist, ia kishte ëndja që kohë pas kohe të merrej me shkrime, kryesisht poezi por ishte temperament dhe shkrimet e tij ishin të papërshtatshme për kohën. Kështu, gjatë ndejave me shokë shpesh kishte dëshirë të citonte vargjet e Migjenit"…vetem unë me ju po kënaqem si fëmija, unë, djepi i juaj, ndoshta edhe varri i juaj".

Pas përfundimit të normales, me sukses të shkëlqyeshëm, punoi edhe dy vite të tjera si mëues ndërsa që nga viti 1973 punon si punëtor i administratës komunale në komunën e Rahovecit ku u dallua si një ndër punëtorët më të mirë, vlerësim ky i cili ishte bërë gjatë mbikqyrjes inspektuese të kryeinspektorit të atëhershëm për financa të Kosovës – Azem Hajdini – Xani, Vibar Hani, etj.

Mirëpo gjithnjë e përcjell fati i keq dhe asnjëherë nuk e lë të qetë të punojë dhe të krijojë sepse si bir i familjës balliste, konsiderohej i papërshtatshëm dhe i rrezikshëm për bijtë e "nënë Titos e të babë Partisë" (kështu e quanin ata veten kur e humbnin durimin), kështuqë shumicën e jetës mund të thuhet se e kaloi si "lepuri nën qen".

Në periudhën e vlimeve politike të viteve të 80-ta hapur demaskon politikën diskriminuese e antishqiptare të regjimit të kohës, kështuqë në vitet 1989-90 u dallua si njëri ndër aktivistët e parë në këshillin nismëtar për themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës – dega në Rahovec. Në Kuvendin themelues të Degës, në Krushë të Madhe zgjedhet delegat i Kuvendit dhe anëtar i kryesisë së Degës të cilin aktivitet e vazhdon për disa vite. Poashtu ishte njëri ndër themeluesit e Sindikatës së Pavarur të organeve të administratës dhe judikaturës së Rahovecit e më vonë nga baza delegohet dhe zgjedhet anëtar i

Këshillit Ekzekutiv të Degës së administratës dhe judikaturës së Kosovës, pranë BSPK në Prishtinë.

Bashkëpunon ngushtë edhe me Këshillin lokal të pajtimit në nivel komunal dhe bashkë me udhëheqësin e mirënjohur të këtij aksioni, tashmë të ndjerin prof. Anton Çetta si dhe aktivistët e këtij këshilli e veprimtarët tjerë të njohur siç ishin profesorët e Universitetit të Prishtinës Rexhep Mehmeti, Mujë Rugova, Zekeria Cana, Hajrullah Gorani e shumë të tjerë, merr pjesë në shumë pajtime të gjaqeve dhe ngatrresave.

Viteve të fundit kohë pas kohe merret me shkrime-poezi të cilat i përmblodhi në përmbledhjen "Krenaria dhe pikëllimi". Këto vite ballafaqohet me sëmundjen e kancerit në mushkëri por ende e përballon me plot krenari dhe dinjitet.

Është entuziast dhe i pandalëshëm ndërsa për miqët dhe shokët ka një shpirt tepër dashamirës.

# PARATHËNJE E AUTORIT - I

Me këto pak fjalë në këtë parathënje, nuk dua që shkrimeve të përfshira në këtë libër të iu bëj ndonjë analizë e aq më pak vlerësim nga aspekti artistiko-letrar duke qenë se një gjë e tillë më së paku më takon mua si autor i një pjese të mirë të këtyre shkrimeve.

Qëllimi im kryesor i të shkruarit të kësaj parathënje është që gjithë atyre që kanë durimin dhe vullnetine mirë për të lexuar, do të thosha këtë fletushkë, pra lexuesve të nderuar që njëherësh janë edhe vlerësuesit më meritorë, të paanshëm dhe objektiv, para se të lexonin atë, të iu ofroj një pasqyrë të shkurtër të motivit dhe përmbajtjes së saj. Pas shkrimeve të mia në përmbledhjet "Krenaria dhe pikëllimi" dhe "Përballje", për të ndërprerë trendin e shkrimeve të natyrës siç është shkruar në ato përmbledhje dhe për të ngulfatur idenë e të shkruarit e të kënduarit në forma më të ndritura , shpërtheu një motiv i ri shtesë si shtytës për të bërë disa poezi apo vjersha që esencialisht nuk dallojnë edhe shumë prej njëra tjetrës , të cilat përshkohen nga karakteri elegjik si një prej formave të letërsisë e cila tek ne deri në kohët e fundit nuk ishe edhe shumë e pasur. Duke qenë se jeta është një arenë lufte ku pa ndërprerë luftohet me sprovat dhe sfidat e saja, shpesh ndodhin edhe gjëra të cilat kushtëzojnë mènyrën e sjelljes, punës dhe vetë jetës së njerëzve, siç janë në shumë raste edhe fatkeqësitë e shkaktuara nga vetë faktori njeri e

veçmas nga një numër të rinjsh të papërgjegjshëm që ngasin makinat në shumë raste edhe duke mos poseduar patentë shoferi. Si pasojë e veprimeve të këtilla edhe unë si gjysh kisha fatin e keq kur në aksident komunikacioni humba mbesën time të dashur, Diellzën e cila ende nuk kishte mbushur njëmbëdhjetë vjet, të cilës i kushtova ciklin e parë të librit , "Kuptoj dhimbjen time".

Ky rast tragjik më mori me vete gjithë idetë siç kam potencuar edhe në vargjet:

"Ide më s'më ka mbetur
të shkruaj as të këndoj,
pa ty që tashmë më ke tretur
jetën nuk mund ta imagjinoj".

(…Fjalë të fundit)

Kjo humbje ishte faktor kyç për të zbrazur tërë llavën vullkanike nga brendia ime shpirtërore në formë vrushkujsh elegjikë por edhe një shpresë që sadopak të ndikohet tek shumë njerëz e veçmas të rinjë të cilët do të duhej vetëdijësuar para se ata vetë të bëhen prindër apo gjyshër. Shpresoj që vargjet në vazhdim sadopak do të prekin ndërgjegjen e gjithë ngasësve të makinave kur të kihet parasysh se:

"Këtë lajm të zi po të merrte dielli
për një çast dritën do e ndalte,
obligim kish ndaj këtij ylli
një minutë dhe ai t'ia falte".
…
"Të gjithë zogjtë këngën do të ndalnin,
së kënduari do të pushonin,
një ditë zi për të do të mbanin,
në vend të këngës do të vajtonin.

(…Premia)

"Lumenjtë rrjedhën kanë ndalur sot,
duket sikur edhe ata do të shterrojnë,
uji iu është shndërruar në lot
vallë, edhe lumenjtë mund të lotojnë?!"
(…Ç'do të ndodhë sot)

Por edhe ato:

"Shumë zemra sot do të pëlcasin
si bombat kur eksplodojnë,
në kupë të qiellit do të bërtasin
zgjohu! Zgjohu! Oooj Diellza jonë!"
(po aty)

Si çdo herë që e kishim në traditë, as tash nuk mungon bashkëndjesia dhe solidariteti i bijave e bijve dhe motrave e vëllezërve anembanë globit kështu që pas publikimit të shkrimeve të mia kushtuar këtij engjëlli te të dy botëve nëpër forume e faqe tjera shqiptare të internetit, vërshuan me shkrimet e tyre duke i kushtuar edhe ata vargje që burojnë nga thellësia e shpirtit dhe zemrës së tyre.

Një numër syresh i mblodha dhe nxora ciklin e dytë të këtij libri, "Zemërbardhët për Diellzën". Kanë shkruar poetë e jo poetë, djem e vajza dhe moshatarë të Diellzës të cilët më së rëndi e kanë përjetuar humbjen e bashkëmoshatares së tyre.

Vlen për të theksuar vargjet e poetit Shaban Cakolli ku thotë:

"Njomzë e xhaxhit plot gjallërim
përherë do mbetesh në vargun tim
derisa të shihemi bashkë në amshim".

Por edhe fjalët e tij:

"Lexues të nderuar, nëse ndonjëherë kam pasur rëndë të shkruaj, atë peshë e ndjeva sot kur fillova të shkruaj për engjëllushen Diellzë. Ndjeva një dhimbje në kraharor dhe nga brenda sikur gufonte një llavë vullkani".

Edona Rexhepaj nga Prishtina ndër të tjera shkruan:

"Errësira ka mbështjellë çdo gjë
me velin e saj të zi,
unë në skaj të botës strukur
Diellzen time mendoj…".

Ndërsa shkrimtarja dhe veprimtarja e njohur nga Nju Jorku, Këze (Kozeta) Zylo midis tjerash shkruan:

"O Diellzë e artë
qe me fiejza dielli ngrohe shpirtin tim
si engjëll më shfaqesh kurorë artë
nga sytë e tu bota merr shkëlqim".

Kurse poetja e mirënjohur nga mërgimi, përkatësisht nga Gjermaia, Alma Papamihali në poezinë kushtuar Diellzës, midis tjerash thotë:

"Nëse një ditë nuk u ndje dielli,
ndodhi veç pak, për një moment
për aq sa ujë kërkonin fushat,
për aq sa lotët mbushën lumenjtë…".

E unë përmes pak vargjeve konstatoj se:

"Ai që në sfida e vuajtje të jetës
Të përvuajturin ngushëllon e i del karshi,
Më e lartë se maja e kullës së babilonit

është qenja dhe humanizmi i tij”.

Dhe për fund më mbetet vetëm të ju udhëzoj drejt brendisë së librit dhe falënderimit publik drejtuar gjithë atyre që bashkëndien me mua dhe familjen time e në çfarëdo mënyre na ngushëlluan. Njëherësh dua që të falënderoj lexuesit e nderuar për durimin dhe kohën e tyre të çmuar që i kushtuan këtyre shkrimeve të mia, të cilët kanë edhe të drejtën e komentimit dhe shprehjes së pikëpamjeve të tyre lidhur me të njëjtat e të cilat komente dhe pikëpamje në çdo rast i mirëpres dhe respektoj.
Autori: Adem Berisha

---

Kjo është fjala e autorit (Adem Berisha) me rastin e botimit të përmbledhjes së poezive “Lulja la lulishten”, përmes së cilës i shpreh pikëpamjet dhe mendimet e tij rreth punës, angazhimeve dhe shtjellimit të bisedave, kontakteve dhe shqetësimeve me të gjithë ata që ndanë pikëllimin, dhembjen, i përkushtuan vargje apo ishin bashkëpjesëmarrës në ngushëllimin për mbesën e tij - Djellzën, e cila përfundimisht u bë Kryepersonazhi i frymëzimit dhe tematikës së krijimtarisë së tij dhe njëkohësisht u bë edhe bashkëpjesëmarrëse në çdo hap të jetës së tij deri në ndarjen përfundimtare nga jeta më datën 15.05.2012.

# PARATHËNJE E AUTORIT - II

Me respekt të thellë për lexuesit e nderuar dhe shpresën për mirëkuptimin e tyre, në vend të një analize në formë të një kritike letrare të librit, e shoh të arsyeshme të shkruaj disa fjalë si parathënie me qëllim që atyre të iu ofroj një pasqyrë të shkurtër  të përmbajtjes së tij.

Që në fillim dua të cek se është evident fakti se kohëve të fundit në mënyrë më të theksuar se sa më parë, jeta dhe shoqëria janë komercializuar dukshëm  si rrjedhojë e nevojës  së angazhimit të secilit që më punën e tij të krijojë të ardhura për të siguruar mirëqenien e tij sociale personale dhe familjare, gjë që këtij komercializimi sikur nuk mund t'i shmangët as veprimtaria krijuese e as vetë kritika letrare.

Në kontekst të kësaj, konsideroj se tek krijuesit kjo më pak vjen në shprehje kur libri shitet më pak se kurdoherë më parë dhe atë me një çmim simbolik për të mos thënë edhe përbuzës.

Megjithatë, pa kontestuar rëndësinë e kritikës letrare, konsideroj se vlerësuesit më meritorë, të pa anshëm dhe më objektivë janë vetë lexuesit të cilët me pëlqimin ose mospëlqimin e tyre, duke mos u fokusuar shumë në disa formalizma, ngarkesa të tepruara me metafora si dhe filozofime të tepërta që më shumë ngarkojnë lexuesin se

sa që çlodhin atë, pranojnë ose jo vlerën dhe nivelin gjuhësor, tematik e letrar-artistik të veprës letrare.

Lidhur me librin që aktualisht keni në dorë, për të mos qenë subjektiv por edhe për shkakun se një gjë e tillë më së paku më takon mua si autor i librit, nuk dua të jap asnjë vlerësim lidhur me vlerën e tij letrare-artistike, gjuhësore, tematike a strukturore përveç se do të thosha që si rezultat i kohës, rrethanave dhe gjithë asaj me çfarë unë si individ por edhe populli im si kolektivitet është përballur në etapa të ndryshme të së kaluarës së tij historike por edhe aktualisht, erdhi në shprehje imagjinata latente në mënyrë që të hedh në letër një pjesë të ndjenjave dhe pikëpamjeve të mia lidhur me disa çështje të caktuara. Pas përmbledhjes "Krenaria dhe pikëllimi" dhe "Lulja la lulishten", tani nxora edhe këtë libër modest nga i cili lexuesi mund të vërej që është shfaqur një mozaik pikëpamjesh dhe preokupimesh ku një vend parësor zë fati i njeriut dhe popullit tim në përballje me sprovat dhe sfidat e jetës në periudha të ndryshme:

"Mendoja e çka nuk mendoja
për shumë e shumë ditë e net,
ç'fat ne mund të kemi
derisa për vete nuk kujdesemi vetë".
(. . . Poema e lirisë)

Për një ndryshim të gjendjes së vështirë me të cilën përballej apo edhe aktualisht përballet individi, populli dhe vendi, sa vije e bëhet imperativ një zgjim jo vetëm i individit por edhe masave të gjëra të popullit, prandaj del si shpërthim një lloj kushtrimi që vërehet edhe tek vargjet poshtë:

"Zgjohu që të mos jesh i mjerë,

përherë i shtypur e poshtëruar,
amullinë hidhe në humnerë
nuk e ke për nder e as të trashëguar.

Mos u hamend për të drejtën tënde madhore
Mos të kaplojë frika, mos të mashtrojë lakmia
Mos të duket nënshtrimi lartmadhëri mbretërore
asgjë nuk ka më të rëndë, nga që është robëria".

(....Zgjohu)

Dëshira dhe gatishmëria për të bërë deri edhe të pamundurën për lirinë e vendit të robëruar si dhe ndjenja se atdheu ende ka nevojë, nuk ka munguar asnjëherë nga bijat e bijtë e popullit si në të kaluarën, ashtu edhe historinë më të re. Një dëshirë dhe gatishmëri e tillë për një sakrificë sublime me bindjen se ndaj atdheut çdo herë kemi borxh të pa shlyer, spikatet edhe në vargjet e mëposhtme :

"Rashë, dhe prapë kisha për të rënë
siç  përherë ishte në traditë ndër ne!
Ndjej se të kisha e prapë borxh të kam
si të vetmin atë, mëmë, zot, fe **... .**

Një jetë të fala, do jepja edhe shumë të tjera për Ty
duke të pasur më të dashurën e më të ngrohtën fole,
ndonëse parajsa më pret, në të nuk dua të hy
pa të shpaguar borxhin o i shtrenjti, i **imi atdhe".**

(... Shpirt e fe . . .për atdhe)

Mirëpo, nuk anashkalohet dot as shfaqja e entuziazmit dhe adhurimi ndaj disa figurave atdhetare dhe të artit e kulturës si shtyllat kryesore të kombit të cilave iu dedikohen edhe disa prej vargjeve të këtij libri:

"Ymer Berishës me shumë shokë
e Ukë Sadikut me trimat tjerë,
që dhanë jetën për këtë tokë
gjallë idenë ua mbajmë përherë".
(... Amanet që vazhdon)

Sikur edhe vargjet më poshtë:

"Treva e Dardanisë jo por, e gjithë Arbëria
sikur nuk është më çfarë ishte më parë,
përse s'këndojnë prapë Qamili, Fatimja, Salihu, Nexhmija**…**
pse Bekimi, Faruku, Ibrahim Kodra**...** u bënë zogj shtegtarë?!".
(... Ngashërim o shpëtim)

Por, nuk mbahet dot i ngujuar as mllefi për shkak të disa fenomeneve dhe dukurive negative prandaj në formë proteste është shfaqur një mllef dhe hidhërim si në vargjet në vijim:

Një aksiomë retorike jo pa shkas është duke u shfaqur:
"Më mirë Sokrat i vuajtur sesa derr i kënaqur".
Ooooh! Ik or sojkeq! Merr botën në sy, tretu e ik, iiiik!
ik nga tokë e shenjtë, diku larg në Azi, Australi,Afrikë"
(...Turpi nuk ka brirë)

apo edhe tek poezia : "Në duel me . . . ty shpirtligësi")

“Ti në shikim të parë jeton më mirë se unë
por, as që më shkon mendja për të pasur lakmi,
pasuri vërtetë nuk kam por, gjumin e bëj gjumë,
natës nuk shikoj në dritare nëse po bie shi”.

Duke qenë se: “shpirti e zemra nuk mplakën kurrë, të reja ngelin në çdo kohë dhe moshë?!”, në fund si freskim janë venë edhe disa shkrime me motive të dashurisë të cilat mbase sadopak do të çlodhnin lexuesin dhe shkëpusin atë për disa çaste nga stërngarkimi i përditëshmërisë me obligime, fenomene dhe dukuri të ndryshme.

Së fundmi falënderoj lexuesit e nderuar për kohën e tyre të çmuar që i kushtuan leximit të këtij libri e të cilët kanë edhe të drejtën e komentimit dhe shprehjes së pikëpamjeve të tyre lidhur me shkrimet në të, të cilat komente dhe pikëpamje i mirëpres dhe respektoj.

Autori: Adem Berisha

---

Kjo Parathënje ishte fjala e autorit (Adem Berisha) për përmbledhjen e poezive “Përballje”. Kishte ndarë disa pikëpamje dhe mendime të tij rreth shtjellimit të tematikës, fenomeneve dhe qëllimeve të tij për këtë pjesë të krijimtarisë së vazhdueshme. Pas një konsultimi e tërheq këtë pjesë të shkrimit, për t’ia lënë mundësinë lexuesit të thotë mendimet dhe mbresat e tij pas leximit të poezive të përmbledhura këtu.

Po e sjell këtu këtë shkrim autentik të tij, duke ruajtur në tërësi ashtu si e ka lënë në dorëshkrim, për të gjykuar lexuesi i tij se sa ishte i rreptë në mendimin, sa kishte qëndrim konciz në fjalën e tij dhe çfarë ishte përkushtimi i tij në krijimtarinë poetike, që tashmë e kemi trashëgimi dhe vlerë të çmuar.

**RAMADAN MUSLIU**

# NË BOTËN E NDJENJAVE SUBLIME

Lirisht mund të thuhet se në shpirtin e çdo njeriu fle talenti latent i poetit dhe se në rrethanat e caktuara objektive apo edhe subjektive, domethënë gjendjës së subjektit, mund të veprojë një agjens apo një stimuls i jashtëm për ta zgjuar atë latenten kreative të artit, që pas kësaj të shpërthejnë impulset e brendshme, të aktivizohet imagjinata dhe aq më parë kërshëria për të zotëruar një botë matanë pervojës senzorale. Ajo shqisa e fshehur e krijuesit e nxitë subjektin nga idealiteti, nga përsosmëria, nga prirja për zotërimin e mjeteve shprehëse, nga perfeksionimi i teknikave. Ka shumë poetë me talent që nuk e kanë "dhuntinë e kërkimit" për të hulumtuar teknika, për ta përsosur metodologjinë e shfaqjes poetike aq sa krijimi i tyre mbetet në nivelin e një "bruto poezie", poezi që ka emocion, që ka ide, që është aktive imagjinativisht dhe emocionalisht, e që operon me mjete klasike. Ky tip i poezisë nuk mëton lartësitë, nuk imponon klishetë, mirëpo është një këngëtim i veçuar, këngëtim për hirë të prirjes së poetit që të mendojë përmes vargjeve dhe figurave poetike, që mendimin poetik dhe emocionin e ngjizur me plot

trazime ta shfaqë me një ritëm specifik, me një tingull që e ka ngjyrën e shpirtit të poetit. Këta poetë nuk i kushtojnë ndonjë rëndësi të veçantë asaj se si do t'i pranojë mjedisi letrar, por më shumë brengosen për nivelin e sinqeritetit, për nivelin e vizionit personal të shprehur përmes vargjeve. Prandaj këto poezi shquhen për një përjetim të sinqertë, për shprehjen e drejtëpërdrejtë, pothuajse kolokviale, sikurse edhe për përafrimet që i kanë me modelet orale poetike.

Pikërisht të gjitha këto tipare i ndeshim tek përmbledhja poetike "Krenaria dhe pikëllimi" të Adem Berishës, krijimet poetike të të cilit përmbajnë edhe agjensin që e ka nxitur krijuesin poetncial të jetë aktiv në gjenerimin e gjendjeve poetike, kurse imagjinatën e tij që të merret me përpunimin artistik të motiveve nga trivialiteti i përditshmërisë, sikurse edhe paradigmat poetike formale që janë përafrime me modelet e poezisë orale.

Së pari, cili është ai agjensi që ka ardhur nga realiteti i përditshëm dhe ka trazuar shpirtin poetik, i cili ka filluar të derdhë magmen poetike?

Agjensi që e ka nxitur të derdh vrushkujt poetik në vargje është momenti historik, çasti fatlum i historisë që po e sendërton ëndrrën e tij personale dhe ëndrrën e shqiptarëve si kolektivitet, ardhjen e lirisë dhe arritjen e pavarësisë, si një ideal jo vetëm politik, por edhe etik i poetit por edhe vështrimi kritik i disa vetive njerëzore dhe fenomeneve e dukurive të papëlqyeshme shoqërore duke mos lënë anash edhe krenarinë që ndien me të mirat e atdheut të tij dhe vlerat tjera pozitive ndër të cilat rradhitë edhe fëmijët si engjuj.

Po qe se ndalemi tek referencialiteti dhe kuptimet që burojnë nga kjo kategori poezishë, do të shohim atë

mrekullinë e imperativit kategorik kantian, madhështinë e ndjenjave të brendshmedhe njëjtësimin e tyre me ligjet kozmike, njëjtësim që kësaj poezie i jep një hapësirë të gjerë kuptimi.

"Kur zoti bëri botën
me plot mrekulli,
i fali kësaj të veçantën
që quhej Iliri.

I fali tokë e det
dhe shumë begati,
i fali edhe një kala
që sot e quajnë Shqipëri".
(…)
("Kur zoti bëri botën")

Poeti në ekstazë nuk gjen kohë për të zgjedhë metafora, për të zgjedhë figura e trope që do rrezatojnë referenca të largëta apo të afërta, nuanca ngjyrash dhe ndjeshmëri të stërholluar, por gjen shprehjen e drejtëpërdrejtë që do ta konkretizojë idenë dhe idealin e tij të gjakuar. Po qe se do të bëhej fjalë për diçka ireale, diçka që parandjehet në vizionin autorial, atëherë kuptimi dhe ideja do të fshiheshin në figura, në mjegullën emocionale, në lojën e imagjinatës, në zikzaket gjuhësore dhe tingëllimin e bukur. Autori qëllimisht insiston në një "bruto poezi", poezi që shqipton ngazëllimin e brendshëm për idealin e prekshëm:

"Fëmijët e vendit tim
janë fëtyrëqeshur e të dlirë,
në gjithë rruzullin tokësor

nuk ka fëmijë më të mirë.

Janë plot shend e verë
me faqet kuq si molla,
janë të shenjtë si engjuj
bukuri nga ta merr shkolla.

Bukuri ka edhe rruga
kur këta e përshkojnë,
këta s'dijnë të urrejnë
por vetëm të dashurojnë".

("Fëmijët e vendit tim")

Duke gjakuar një shprehje të drejtëpërdrejtë autori sikur na thotë se për synim ka të komunikojë me lexuesin, të dialogojë me të, të ndërtojë një vizion kongruent me lexuesit, sepse i njëjti ideal, e njëjta përpjekje duhet të ketë edhe gjuhën e njëjtë. I dhënë pas këtij lloji të komunikativitetit të shprehjes poetike, gjithnjë duke i qëndruar besnik modelit të poezisë orale, autori sikur i përafrohet poezisë korresponduese me atë për gjeneratat më të vogla, por duke mos harruar se poezia e tij e gjendjeve ekstatike është një lloj kënge, një lloj tingulli që buron nga zemra.

Nuk është e habitshme pse poezia "Dasma e lirisë" mund të konsiderohet se është thjeshtë një këngë epiko-lirike, një këngë që për nga thekset e saj himnike, por edhe me nuancime të herëpasherëshme melankolike, sikur na e kujton poezinë e Vaso Pashës "O moj Shqipni".

"Eu sa leu dielli o mbi at kodër
u hap lajmi-o n'Shkup e n'Shkodër
nga Evropa e n'Amerikë,

nga Azia në Afrikë,
prej andej n'Australi
se n'Kosovë ka një risi
i madh e i vogël o janë bë një
eu kanë nis luftën o për liri.

Eu n'Dukagjin t'Binak Alisë,
u lidh besa e shqiptarisë,
me ia kthye pushkën Serbisë,
për t'a mbrojtë prangun e sh'pisë.

Si luaj djemtë e Lirisë
të betuar n'besë të Zotit
si në kohën e Kastriotit
si ç'vepruan të parët e motit"
(…)

Modelet orale të selitura brenda vargjeve të këtij autori me shumë përgjasime me idetë rilindase sikur na kujtojnë një vazhdimësi, një përpjekje që trashëgimia jonë dhe ideali ynë të ketë rrënjë historike dhe si i tillë të na obligojë për një pikëpamje etike që duhet të jetë orientuese në jetën e mëtejme në pushtimin e hapësirave të lirisë konkrete.

Duke kaluar nga shkalla e idealitetit dhe realizimit të idealit, do të thosha edhe politik, autori zbret në tokë, zbret në realitet. Mirëpo në një mal dëshprimi gjithnjë del diçka që i jep kuptim vazhdimësisë së jetës dhe autori vazhdimisht e mban gjallë atë zjarrin promethean, vlerën e sakrificës, të cilën herë e gjen tek dëshmorët, tek heroinat duke zënë në gojë Shotë Galicën, Xhevë Lladrofcin, etj. herë tek mantelbardhat, herë tek gjeneratat e reja që duhet ta marrin mbi vete barrën e historisë.

Mirëpo në këtë cikël, krahas glorifikimit të veprave të vyera siç është sakrifikimi i femrës shqiptare gjatë historisë dhe në aktualitet, poeti ndesh edhe gjërat e shëmtuara, të cilave përpiqet t'ua heqë maskën, t'ua çjerrë lustren shkëlqyese të gënjeshtrës:

"E thjeshtë e primitive,
pikëpamjet arkaike,
e tëra është destruktive,
këtë kurr s'mund ta bësh mike.

Të mirën nuk e njeh si të mirë
dhe nuk di ta vlerësojë,
atë e këthen me të keqe,
ç'dreq kështu e mësoi?!

Gjuhën e ka gjarpër
e turirin si derr,
ditën nuk e njeh si ditë
e drita i duket terr".
(…)

("Ledhatia e djallit")

Është i njohur fakti se dhëmbja e madhe shpesh arrin të nxjerrë poezi të bukur, sikurse që është rasti me librin "Lum Lumi" të Ali Podrimjes. Diçka e ngjashme ndodh edhe me autorin e këtyre poezive. Ai arrin të ngrihet mbi dhëmbjen përmes krijimit poetik, duke derdhur dhëmbjen në një sublimat lirik.

Dhe në fund fare, pas një ekskursi nëpër vargjet e librit të Adem Berishës, mund të themi se lexuesi ndahet me mbresa të nduarnduarta, por më e fuqishmja është ajo se i bëhet që ka shëtitur nëpër një botë në radhë të parë emocionesh. Për këtë poezi, duke bërë analogji me

“pyllin e simboleve” të poezive të Bodlerit, mund të themi se këtu kemi të bëjmë me një “pyll ndjenjash”, ku më të fuqishmet janë ekstaza për lirinë dhe dhëmbja për humbjen tragjike të mbesës, dy emocione këto, ku njëra është horizontalja, kurse tjetra vertikalja emocionale e librit.

---

Ky shkrim është botuar si Parathënje për librin e parë poetik “Krenaria dhe pikëllimi”. Po e sjellim këtu që lexuesi ta ketë një pasqyrë sa më komplete rreth krijimtarisë së Adem Berishës dhe mendimet e mbresat e lexuesit, të njohësve dhe krijuesve të artit poetik, duke i njohur vlerat dhe synimet e autorit.

**XHELADIN MJEKU**

# SPROVAT E JETËS SI FRYMËZIM LIRIK

Adem Berisha vjen tek lexuesi me vëllimin e tij të tretë poetik, si rezultat i një pune me përkushtim duke u përballur me sprovat e jetës dhe fenomenet e dukuritë që e preokupojnë dhe sfidojnë parreshtur. Në çastet kur po përballoja rrugëtimin plot befasi dhe retushime të reja estetike në poezitë e "Përballjes", para më qëndronte trinomi enigmatik i Adem Berishës. Ai vinte si poet, rapsod dhe si vështrues i kujdesshëm ngjarjesh historike me elemente të dëshmitarit të kohës, që vepron me ngulm në skalitjen e gurit të kalasë poetike të tij dhe që shpërthen si vullkan, në të shumtën, plot mllef e dhimbje. Sidoqoftë, në këtë trinom poeti e ka fjalën kryesore, pa lënë anash edhe faktorë të tjerë si ndërlidhje funksionale e krijimit të vlerës poetike që prezanton.

Kjo poezi mëton ta thyej gëzhojën e botës fëmijërore dhe të frymoj me botëkuptimet e të mëdhenjëve, por kujdesshëm dhe me ndruajtje ecën tehut të shpatës së të dy brezave paralelisht për të hapur shtegun e ri të pjekurisë poetike.

## Ndërtimi epiko-lirik i opusit letrar

Lirikat e këtij libri, jo kushtimisht motiveve dhe formës së komunikimit poetik me lexuesin, janë të vendosura në ciklet: *"Kronikë që flet vetë*", "*Poema e lirisë*", *"Dje trimëresha, sot skolesha*", "*Lazdrajkë që rrëmben*" dhe *"Çfarë prish gjakun e dëlirë"*, të cilat bëjnë bashkësinë poetike të "*Përballjes*". "*Parathënja*", "*Mesazhe e dedikime miqësh*", dhe "*Pikëpamjet*", vijnë si pjesë përcjellëse duke e plotësuar librin, të cilat e përkrahin ndërtimin e një fizionomie të qëndrueshme dhe të mirëpaisur.

Kështu, poezia e Adem Berishës shquhet për vargun epiko-lirik, i cili përshkon dukshëm krijimtarinë e tij e i cili rri pranë frymës autoktone të ligjërimit epiko-heroik. Harmonia e vargut sjell ritmikën poetike që na kujton melodinë popullore dhe përafron me nuancime të këngës rapsodike, duke mos iu shmangur kapjes së fijes së ngjarjes që në nismë, si tek "Amanet që pret…", "*Hallkë çeliku e historisë*" dhe ndonjë poezi tjetër që i përafrohen këngës rapsodike. Tek Adem Berisha veçojmë edhe stilin fishtian e atë të poezisë së traditës që korrespondon me vargun epik, i transponuar mirë në mesazhin që ajo përcjell.

Një numër i konsiderueshëm i këtyre poezive, përveç strukturimit katër vargjesh, ritmit dhe rimës, vargut konsonantik dhe semantikës që dominon pothuajse në tërë përmbledhjen poetike, kanë edhe funksion të përceptimit të tërësisë motivore dhe asaj tematike.

Që në fillim të shkrimit poetik autori shpalos qëndrimin, mallin dhe gatishmërinë që të sakrifikohet për "*At-Mëmëdheun e tij*".

Baraspeshimi i fajit me atdheun shpalos qëndrimin kulmor plot mall:

“Unë nuk jam fajtor pse të dua
Nuk jam fajtor pse s’rroj dot pa Ty,
Ti më jep krahë për të fluturuar
Po u kërkua fajtori, jemi që të dy”.

(“Kush është fajtor”)

Ligjërimi poetik vazhdon rrugëtimin gjithandej nëpër ciklet e radhës duke i kënduar vendit, personaliteteve të merituara të kauzës sonë, figurave të artit e kulturës si dy shtyllat themelore të një kombi por, një veçanti krijuese vjen nga kjo penë edhe me synimet për socializimin me situatat dhe ndryshimet e rrjedhave shoqërore të vendit të tij. “*Poema e lirisë*” shtrin rrezeveprimin e saj në gjithë hapsirën ku lufta dhe heroizmi flasin me emra të përveçëm, si Isa Boletini, Hasan Prishtina, Dedë Gjo Luli, Sadik Rama i Gjurgjevikut, Azem Bejta, Adem Jashari, Azem Hajdini-Xani, Abdyl Krasniqi, e tjerë, të cilët dëshmuan vlera sublime për kauzën kombëtare në etapa të ndryshme të së kaluarës dhe të tashmes.

Cikli poetik *“Dje trimëresha, sot sokolesha*” vjen me përkushtime dedikuar emrave të kulturës, humanizmit, vlerave dhe miqësisë që kurorëzohen me falënderimet dhe mirënjohjen e autorit përgjatë gjetjeve frymëzuese bazuar në faktografinë e vlerave dhe ngritjen lapidare të shumë personaliteteve, ndër të cilat spikaten dr. Silva Bala, Nexhmije Pagarusha, Elena Gjika, Xhevë Lladrovci, etj.

Nga modestia e autorit që temat e ngjarjet t’i prek kujdesshëm dhe pa bujë, takojmë edhe ciklin me motive të dashurisë “*Lazdrajkë që rrëmben*”, në shtjellimin e të cilit edhepse i vogël si vëllim, ndihet një ndjeshmëri e hollë e autorit, pa pasur për pretendim përshkrime të

ngjarjeve por, me një çasje të kujdesshme dhe shprehje të ndjenjave të theksuara të dashurisë, si tek poezia *"Edhe nga parajsa do të ik"*, ku citojmë:

"Nuk kam çfarë flas, të kam mbi çdo gjë në botë
të stolisur me virtytet më të mira që ka një njeri,
ndaj, mos u befaso pse të dua më fort se fort,
edhe nga parajsa do të ikja, që të kthehem tek ti".

## Grotesku dhe sarkazma - pasqyrime të jetës që provokon

Shpërthimi i protestës së zëshme përmes vargut në shumë poezi, vjen si prodhim i një pakënaqësie të grumbulluar prej kohësh në përballje me dështimet dhe keqinterpretimet e ndryshimeve të shoqërisë si dhe abuzimet me vlerat e mirëfillta.

Emërtimi i ciklit "*Çfarë prish gjakun e dëlirë"* tingëllon qortueshëm për "*paradokset*" e njerëzve dhe shikimin në "*retrospektivën* " e bujshme të veprimtarisë anakronike të tyre, nëpërkëmbjen e vlerave të shumta nga puthadorë dhe keqbërës të sojit të veçantë, që kryesisht karakterizon frymën e poezisë të përshkuar nga sarkazma dhe ironia. Ky cikël që simbolikisht është rrumbullakuar në frymën e ngjarjeve, po të zbërthehet në kuptimësinë e tij, nënkuptont gjithçka që në vete ngërthenë tematika e trajtuar, me insistimin për luftimin e shpirtligjve, veprimeve primitive, abuzimeve dhe devijimeve shoqërore që për tendencë kanë prishjen e gjakut të njeriut të mirë. Në një peridhë të gjatë kjo ishte "sëmundja e kohës" e cila gllabëron vlerat e arritura me angazhimet dhe përkushtimin e njerëzve të devotshëm që për ideal kishin lirinë, progresin dhe ngritjen permanente

të vlerave, del sheshit se keqbërësit injorantë nuk kanë kohë dhe ideale të shëndosha por, kanë interesa dhe ambicie për përfitime të pandershme nga veprimet e tyre të errëta, veti këto të këqia, të cilat me penën e tij të mprehtë i kapë autori, duke i trajtuar në mënyrë të rreptë, plot sarkazëm, ironi e deri në përbuzje. Groteska e kësaj kaste njerëzish shkon aq larg sa bën të humbasësh durimin për të shfryr mllefin deri në masën e urrejtjes:

"Po ju nga erdhët oj faqja e zezë, o të mjerët ogurzi?!
Po, po e di, ju jeni vetë djalli me shpirtin e tij të zi!
Oooh! Ik ti or sojkeq! Merr botën në sy, tretu e ik, iiik!
Ik nga tokë e shenjtë larg në Azi, Australi,Afrikë".

("Turpi nuk ka brirë")

Si revoltë ndaj kësaj "sëmundjeje të kohës" që kishte për tendencë gllabërimin e vlerave të arritura me djersë e gjak të njerëzve që për ideal kishin atdhedashurinë, lirinë e civilizimin, poeti edhe tek pikëpamjet e tija ndër të tjera shprehet": *"Është e pafalshme të shtiresh atdhetar kur veprat të nxjerrin antikombëtar!!!"*

Kjo që u shqyrtua këtu dhe në shumë poezi tjera të këtij cikli, si: "*Myk mesjetar*", "*Mjeranët*", "*Në duel me shpirtligësinë*", e ndonjë tjetër flasin për përkushtimin e Adem Berishës, gjithnjë duke synuar ndryshimin e veseve dhe karaktereve të ulëta njerëzore në shoqërinë e re. Kjo e keqe duket sheshit dhe kërkon trajtim të kujdesshëm mbase për një kohë të gjatë.

## Përmbyllja si mesazh

Gjatë leximit të poezisë së Adem Berishës, veçanërisht këtë të fundit, vërejmë një kronologjie të zhvillimeve dhe

ngjarjeve të shumta historike, kulturore e sociale në zingjirin e jetës dhe aspiratave shekullore të ngritjes nga harresa, sfidimit të lirisë shpirtërore në kontekstin e rindërtimit të jetës, përpjekjeve të parreshtura për kapërcimin e ngecjeve të shoqërisë në periudha të ndryshme kohore në përballje me realitetet e krijuara.

Nga përshtypjet e lexuesve dhe adhuruesve të fjalës poetike, që kanë bërë komente të ndryshme dhe përkushtime poetike për autorin e këtij libri, shihet qartë se kjo poezi lexohet dhe absorbohet mirë nga masa intelektuale dhe krijuese. Këtu veçohen mendimet dhe vlerësimet e shkrimtares, publicistes dhe veprimtares së shquar Këze (Kozeta) Zylos, Alma Papamihalit, Gentian Banajt, Riza Çatos, Edmond Shallvarit, Tonin Nikollit, e ndonjë tjetër që do t'i takojmë në vijim.

Vlera e poezisë së Adem Berishës, shikuar në prizmin e qasjes poetike të temave që trajton, matet me ndjesinë që bartë dhe peshën e mesazhit që sjell përgjatë rrugëtimit të saj në kodin etik e historik me insistimin për kapjen e bërthamës së qëllimit, derisa qëllimi dhe synimi i saj është ndreqja e defekteve të shoqërisë dhe ndërtimi mbi baza të shëndosha, si një inspirim krijues dhe si imperativ për të favorizuar e ndërtuar një të ardhme të ndritur të shoqërisë dhe vendit të tij, duke u bazuar në shëmbëlltyrën e shumtë e të mirë të popullit të vet përgjatë gjithë të kaluarës së tij historike.

---

Ky shkrim është botuar si Parathëne e përmbledhjes së tretë poetike "Përballje". Vjen këtu për të plotësuar mendimin dhe vlerësimet e krijuesve, njohësve dhe studiuesve të poezisë së Adem Berishës, me qëllimin e rrumbullaksimit të një materje sa më përfshirëse rreth krijimtarisë së tij.

# II
# PËRKUSHTIME POETIKE

## Adem Zaplluzha

### MIKU IM I FJALËS

*(Poetit Adem Berisha)*

Shitësi i gështenjave
I di emrat e të gjitha zjarreve
Në maja baladash
Sa e sa herë i ka pjekur gishtat

Në tokën tonë kur vinin
Të paftuarit
Miku im sa ora
Shndërrohej në zjarr

Bëhej hi e pluhur
Dhe sërish lindte nga hiri
Miku im i gështenjave
Miku im i fjalëve

Asnjëherë nuk foli
Pa i pjekur fjalët si gështenjat
Miku im i fjalës
Miku im i gështenjave

## Agim Gashi - Drenica

### TAKIMI NA NGELI PENG...

*(Një poet, një mik i mirë - na iku humanisti, atdhetari - Adem Gjurgjeviku.)*

Pse ike o vëlla i dashur
pa na thënë lamtumirë,
- ti shkove të Djellëza
në do ta kemi vështirë.

Kush do t'na fleta aq ëmbël
më fjalët - sheqer,
mungesën tënde o vëlla
do ta ndjejmë çdo herë.

Pikëllimin që t'solli jeta
e mbajte për vete n'brendi,
për miqët rrezatove veç gëzim
gjithmonë na fale veç dashuri.

Një plagë ma hape n'zemër
- në shpirt më le një brengë,
- pse ike o vëlla i dashur
- takimi na ngeli peng.

## Agim Metbala

### EMBLEMË KOHE

*Akrostik*

**A**, me A fillon emri ATDHEU
**D**ashurinë ia fale nga thellësia
**E**mblemë e pashlyeshme ndër mote
**M**beten relikte në papirus

**B**ezdisshëm kërkove frymëzimin
**E**ce gucimshëm kohës së ligë
**R**efrenin drejtësi e kërkove me llupë
**I**mponimin e injorove deri në përbuzje
**Sh**eshas në kërkim të bardhësisë
**A**ureolë Kosovës dhuratë

## Agron A. Berisha

## DIELLZËS DHE BABUSHIT TË DASHUR

Sa shumë ju deshëm
sa njerëzit na e kishin lakmi,
sa shumë dhimbje pas na latë
athua duron dot njeri ???

Sa shumë zemra të thyera mbetën
ato sot lot po pikojnë
mendja dhe zemra kanë bër pakt
kurrë për jetë s'do t'ju harrojnë

Sa shumë mall në zemër mbeti
ajo tash vuan dhe bërtet
Diellzë, Diellzë ... Babush !
pse ikët , pse ikët e na latë vetë ?

Vdekja mëshirë athua paska ?
nga kjo botë aq herët u ka nda
Por si duket u pendua dhe prapë ju bashkoi
E ne, ne duke qarë na la !!!

## Ardit Berisha

## BABUSH... PO TI PSE IKE???

Sa e rëndë ishte kjo gjë
Nuk mund ta them me fjalë
Më erdhi si papritmas kur më thanë:
Babushi ynë i dashur nuk është më gjallë .

Ishe shumë i apasionuar pas librave
Miqtë e tu i doje më shumë se veten
Mundoheshe të na bëje të lumtur
Edhe pse ndonjëherë hidheroheshe në vete .

Për ty hidhërimi nuk ishte gjë
As ti e unë qëndronim pa njëri-tjetrin
Ndonjëherë fjalë të rënda t'i kam thënë
Por sërish m'i ktheje si të mos kishte ndodhur asgjë.

Ishe personi i fundit që doja të vdisje
Me ty kaloja çastet më të bukura të jetës

E pasi kaloja çdo lloj trishtimi
Ti më merrje e më thoje se përsëri do lindi dielli

Tani që ti ike ...
Kush do luaj me mua ?
Tani që ti ike ...
Kush do më dojë mua ?

Kishe dëshirë të shkoje sa më parë te DIELLZA ...
Ja, t'u plotësua dëshira,
Por për mua e për Arbërin
S'do ketë mbarim mërzia .

LAMTUMIRË  BABUSH !!!

## Artan Almeta

### NJË MIKU!

*(Kushtuar Poetit Adem Berisha)*

Ku paskam qenë muaj të tërë?
Në ç'gjumë paskam qenë, O Zot!
Si dhashë mikut një lamtumirë
Për të nuk derdha një pikëz lot.

Një mik më tha se nuk je më
Dhe se ke ikur përjetë nga ne,
Në gojë s'më mbet' më fjalë, as zë
Dhe përmbi kokë mu nxi një re.

Më ikën fjalët, larg u degdisën
Morën shtigjet e arratisë
Oh, dhimbjet gjoksin seç ma grisën
në zemrën time ngulën një shtizë.

Të gjithë do vdesim një ditë patjetër
dikush më vonë, dikush më parë
I lutem Zotit, në botën tjetër
Që ta ringjallë si besimtar.

## Besmirë Bytyçi

# KUJTIMI QË S'VDES

*Bacës tim Ademit*

Ti ike e na le me dhimbje e plot mall
Loton qielli e po na dënes shpirti
Kalojnë ditë e mote e asesi ta marr veten
Si mund të pajtohem me këtë realitet
Që na vrau zemrat e na plagosi ndjenjat.

Nuk arrij ta besoj që baca im shpirtmirë
Në mesin tonë më nuk frymon
Nuk dua të besoj asnjë çast
Që buzëqeshja jote na iku përgjithmonë

Ti ishe shembull në mesin tonë
Na jepje frymëzim në gëzim e hidhërim
Për ne ishe prind, gjysh, ishe edhe vëlla
Ndoshta asnjëherë mjaftueshëm s'ta thashë
Se sa Ty të dua!

Por, baca im
Asnjëherë nuk mund të të harroj
Ti do jetosh në zemrën time
Do të jesh i gjallë në kujtesën tonë

Do të të gjej gjithmonë
Aty ku ti e gjeje veten pambarim
Do të të takoj në poezitë tua
E do të jesh frymëzim për vargun tim

Do të të kujtoj çdoherë ashtu siç ishe
Njeri zemërmadh e shpirtmirë
Të buzëqeshur dhe plot dashuri
I urtë e fjalëartë deri në mrekulli
Të dashur e njeri të rrallë
Bacë, ti gjithmonë je  gjallë!

## Besnik Ceci

## LUTJA E FUNDIT – MË FAL BACË ADEMI!

-Me falë,Bacë Ademi, që sot,
Në shpirtin tim sundon dhimbja!
Por s'duroj dot!
Më fal, që me lotin tim,
Qiellin e mbusha me re dhimbjeje!
Se për mua, sot, s'kishte agim,
Vatra e shpirtit shqiptar,
Pësoi shumë dridhje.
Një ditëz, Diellëza iku,
Në më të bukurin lulëzim,
Sa më dhembi ky xhan!
Por tash, më dhemb më shumë,
Bahqja jote e dashurisë,
Sot, mbeti pa bahqevan!

Më fal !Më fal!!!!!!

## Besnike Dervisholli

# MOS QANI PËR POETIN

*Në kujtim të Adem Berishës*

Sot dita ishte e veshur me pikëllim,
Forca mungonte nga dhimbja,
Sytë lotojnë rrëke për humbjen e mikut,
Për ikjen e mësuesit e poetit të devotshëm,
Po si të shkruaj vargje pikëllimi për ty?
Jo, jooo nuk mundem asessi!

Ti ishe shërues në çdo rast pikëllimi,
Me këshillat atërore na ktheje buzëqeshjen
Forca dhe kurajo nuk të mungonte kurrë,
Bindeshim kur flisje për shtigjet e jetës,
Na këshilloje të përballemi edhe me pikëllimin.

Të hesht sot për Ty nuk mundem për asnjë çast,
Tepër trishtueshëm kur shoh atë foto me shirit të zi,
Shoh buzëqeshjen tënde dhe shikimin kah ne,
Se fotoja flet shumë, këtu u binda vërtetë,
Ai shikim i mprehtë sikur na qortonte për lotin,
Mos qani kur po ik tek pjesa tjetër e zemrës,
Me Diellzën tashmë jemi të përqafuar të dy!

16.05.2012

## Briliana Sharova

### "SOT JEMI..., PO NESËR " !??

(DEDIKIM I NDARJES NGA JETA,TE MIKUT TIM - ADEM BERISHA)

Nuk u drodh agimi, por vesa mbi damarët e gjethes,
Më nisi lajmin e KOBESHËM të humbjes, të ndarjes.

Shpirtit, më jehon ende tastjera e germave të mbrëmshme:
- "Sot do të shkoj në Prishtinë"
- një promovim, - aty të priste !!!

Dita rrembeu kryet, do më flisje __
se si ja kalove mes miqsh poet...
...por lajmi i hidhur i " Humbjes tënde ",
më erdhi më shpejt !!!

## Drita Krasniqi

### LAJM I ZI E MORI DHENË

*(Adem Berishës)*

Kur mora lajmin korb të zi
Se në jetë më nuk je ti,
O Adem o bacë i dashur
S'po më teret loti n´sy.

Ishe trim e shkuar trimit
Zemër bujar e poet,
Sa t'jetojmë n´këtë botë gratçore
Ti n´kujtime na ke mbetë.

Lamtumirë o bacë i dashur
Në atë botë që sot po shkon,
Qenke gëzuar o vlla i dashur
Që Djellzen tënde po e takon.

Lamtumirë burri i Kosovës
Po të them nga Italia,
Do t´jetosh ti përgjithmonë
Në këto kujtimet e mia.

E paç t´lehtë dheun e zi
Që para kohe po të mbulon,
Vepra jote s’do të harrohet
Me nder populli do të kujton.

Drita Krasniqi
Itali
16.05.2012

## Enxhi Krasniqi - Bardhaj

### PËR TY BACA ADEM

Kur pena e poetit rrokulliset pa e thënë të tëren
Vargjet qajnë!...
Qajnë besnikërisht lulëzimet nëpër libra
ndërthyer nga zemërimi,
duke kthyer fjalën në vaj,
E shpirtrat e miqësisë në dhembje pa skaj .

Pse u deshka të pajtohemi se pena e ngjyer
mbet pa të zotin!...Pa gjuhën maleve.
Si të pajtohemi me këtë formë të gjykimit
Që mori bacën Adem ,
Mu në kohën e admirimit.

Jo- jo nuk mund ta pranoj se kemi humbur
Një mik kaq të mirë,që nuk njeh trembjen
Një njeri kaq madhështor,
Një burrë kaq të fortë me shpirtdhembjen!...

Pikëëëëë loti për mikun e artfjalës
Për mikun e Këshillës
Mikun e Besës
Që iku në përqafim të mbesës!...DIELLZËS!...

## Fahrije Krasniqi – Kllokoqi

### NJË LIS RA

Nga lajmi për vdekjen e Adem Berishës

Sonte s'ka as hënë as yje
katran i zi kaploi qiellin që ishte i kthjellët si loti
edhe deti qante për anijen
që u fundos nga dallgët e forta të kësaj stuhije
toka u dridh nga trishtimi
në këtë natë kobzezë një lis ra!

## Faton Mehmeti

### IN MEMORIAM

Adem Gjurgjevikut

Vdekja na tregon sa të dobët jemi
por dhe vdekja e bën edhe të fortë
fjalën tënde
ike ashtu siç erdhe
pa fjalë
por le shumë vepra

lutemi për ty FALEMINDERIT..

## Gentjana Avdiaj

### PA TITULL

Në trup vajton mortshëm një dhimbje,
në sytë e përmbytur loti s'po flen,
një zemër s'rreh më, hesht përgjithmonë,
por jeton mes nesh shpirti i Bacës Adem.

Mungon zëri i tij i ëmbël,
si përkëdhelje flladi pranveror,
mungojnë thinjat e tij të bardha,
që nipërit t'ia lëmojnë me dorë.

Mungon buzëqeshja e mirësisë,
mungon shpirti i tij fisnik,
dikush lart e pat ndarë atë për vete,
ndaj vdekja k'të ditë i zuri pritë.

Ku të të gjej Baca Adem,
të të shtrëngoj dorën si dikur,
Mes nesh vdekja klith e heshtur,
në kohë të ngrira bërë gur.

U nda nga jeta një mik i rrallë,
pa gojë na la, me bindje e them,
dhimbje e madhe humbja e tij,
Lamtumirë përgjithmonë Baca Adem.

## Halil Xani

# MIKUT TIM ADEM MIKMIRIT

Lajmi i kobshëm mori dhenë
Zogjët pushuan këngën sot
Vesa nëpër gjethe mali
Hej seç u shndërrua në lot

Heu pushoi zemra e madhe
Heu pushoi një gojëbilbili
Sot dhe vesa u kthye në lot
Në maje bari, në maje tërfili

Sa e rëndë më dukesh, penë
Që të shkruaj për mikun tim
Sa vështirë, heu sa vështirë
Nuk po di të gjej ngushëllim

Gjithë shoqëria po çuditën
Ku e gjete gjithë atë fuqi
Me të gjithë e gjithmonë
Goja jote mjaltë-flori

Miku ynë, Adem mikmiri
Sot u bëre pjesë amshimi
Deri sa të na mbulojë hiri
Për ne do t'jesh lulekujtimi

Më 16 maj 2012

## Hasime Hoti

### LAJMI I ZI

Në derën time sot trokiti
Një lajm i kobshëm e i zi,
Zemra m'i ndaloi rrahjet
S'mund po e ndali lotin në sy.

Të thirrja gjysh, o njeri i dashur
Adem Berisha, o poet,
E ti më thoje me dashuri
Ku të kam e imja mbesë.

Tani kujtimi po ma vret ballin
Gjithnjë do të kujtoj Ty,
Do t´jetoj n´kujtimet tona
Duke qajtë si një fëmi.

Në qershor n´këtë muaj të vitit
Të thashë se atje do të vi,
Ti më the me fjalë të ëmbla
Mirë se vjen, Cime moj bi.

Pusho prajshëm në amshim
Në këtë botë s'do t´shihemi ma,
Porse në atë botën tjetër
Bashkë do t´jemi si pa pra.

Me respekt: Cimja e Adem Berishës
03/05/1948
15/05/2012

## Haxhi Muhaxheri

# KA ARDHUR POETI

*Në respekt të bacës Adem Berisha - Gjurgjrviku*

Kush tha se iku Ademi
ai veç sa ka ardhur

I buzëqeshin vargjet

## Imri Trena

### BISEDA ME LOT

Mikut i telefonova në Gjermani
Mezi munda të njoh zërin e tij!
- A je TI miku Shaban? Pse ky zë?
- Po, vetë jam! Një lajm m`ka vra!

...Baca Adem Berisha - Gjurgjeviku
Mbylli sytë përgjithmonë! Na iku...!

- Paska shkuar te Diellza
Që e deshi aq shumë;
Me zë të përvajshëm
E "ngushllova" unë!

Pastaj, Ai foli për takimet
E kujtimet e shumta për të me mall,
Unë për vargjet e tija plot vlera
Të emituara në RZA ditë më parë.

Ishte mendim i përbashkët me mikun,
Njerëzve për së gjalli s`u dihet vlera,
Bacë Adem, kujtim na mbetën vargjet tua
Dhe...e vonuar pranvera.

## Ismet Tahiraj

## BACA ADEM BERISHA

E humbëm mikun
si rrezen e diellit,
kur na dha këshilla
e lulet e prillit.

Kur na tregonte
për rrugët e vështira,
kur ërrët dimërave
derë e përhitur.

Na la me dhembje
e me udhërrëfyes,
atdheun ta duam
më shumë se sytë.

Ndaj shqiptarizmës
horizont ndritë...

## Izet Abdyli

## ADEM MIKU SHPIRT POETI

Thonë një yll zbriti nga qielli
E  shndëriti si meteor
Fjala tij u përflak
Për flamur qiell e tokë

Kur ne prisnim vargje të reja
Plote aromë e ngrohtësi
Ti na ike aq papritur
Pa na thënë lamtumirë

Adem miku shpirt poeti
Ti na mbete në kujtime
Madhështia e veprës sate
Nuk ka vdekje veç rilindje

## Lavdim Dushi

### LAMTUMIRË BACA ADEM

Fjalë të rëndë dëgjova unë,
Baca Adem do të na mungosh shumë
Dritë e zezë po i bije qiellit
Në ketë ditë po të merr dheu.

Lamtumirë Baca Adem
Mall për ty do të ketë ky vend
Lotët nuk ndalen o miku im
Ishe bashkëfshatar i vendit tim.

Në Gjurgjevikë ditë zije po i shkon
Humbi jetën miku ynë
Lulekuqja nuk lulëzon
Në amshim do të shkosh.

Ditë e zezë në Gjurgjevik
Por këtë ditë nuk e kemi pritë
Baca Adem sot i mbyll sytë,
Lamtumirë o miku im...

## Lili Bimi

## KURRË NUK VDES BACA ADEM!!

Edhe qielli po vajton
Shpirti im shumë rënkon
Malet ushtojnë
E mallkojnë
...
Deti tallaze të larta ngre
Sot o baca Adem ti na le
Medet....
Ti që na ke mësuar Atdheun ta duam
Për liri të gjithë të luftojmë
Dhe dashurisë t'i këndojmë

Tani kur më së shumti iu deshte Dardanisë
Ike në amshim
O Bacë Ademi
Shkrimtar i shpirti tim

Ke ndërruar jetë
Por s'ke vdekur
Shpirti yt i madh e fisnik
Jeton e frymon në zemrat tona
Sot
Nesër
Edhe në amshim!

16.05.2012

## Mentor Thaqi

## PËR LOTIN, MË FAL O BACË!

*(Bacës Adem Berisha me plot dashuri, n´përkujtim)*

Ah, lapsi im i zi
n´letër t´bardhë
tashmë t´zhubrosur,
t´shkruaj
deshta diçka tjetër
e jo atë dhimbje t´vjetër!

Ev, ev, ev!
Po rrallohen Lisat,
më tha një vëllau im Poet (S.Rr.)
njëherë
në një rast të ndjerë,
ne në g´rrithje shpirti
nga trishti,
nga malli,

nga loti i fshehur
dhe vaji i heshtur,
po po,
ata Lisat e Epokës
n´përballje motesh
me padrejtësitë e Botës
n´ecje kundër t´kohës,
se vështirë
ishte,
t'i vëmë harrën cohës!

Poet,
o Baca Adem Berisha,
sa herë deshte
n´fis t´më marrësh,
eh eh,
dashurisë
kapak
kush dot s´i vuri,
Gjurgjevikut
Emrin nga Sadik Rama
ia ndjeva,
rrugën
nga Emri Yt
ia mësova,
se qebesa
dardha nën dardhë
pikë,
e në mbarësi
le t´bëhen trashëgimitë
se, ai që ishte
dhe kishte,
do të jetë dhe ketë
Nderin virtyt

me Traditë,
Emri Yt
do ruan fisnikëritë!
Bac, na falë për lotin,
të kemi dashtë,
pasha
dhe pashë motin
që kjemë bashk
në halle t´Dheut
me mall t´Atdheut
o Burrë i Dheut!

## Merita Lulaj

### DHIMBJA S'KA MËSHIRË..

…Sot një yll i përgjakur çel mëngjesin
Në heshtje po i shkëmbej dy fjalë me ty
Të të themi lamtumirë kurrë nuk deshëm
Eh, vdekja e ligë, tinëzare, që s'ka mëshirë…

…Heshtje sot, vargjet e miqësisë vajtojnë
Dhe zogjët e malit e ndaluan këngën sot
Sot buzëqeshjet e mirësisë u mungojnë
Dhe kushdo që e mori këtë lajm u përlot...

…U nda veç fizikisht Baca Adem, ai jeton
U ndal një zemër, u shua një yll, një meteor
Ai jeton vargut tij, jeton në çdo shkronjë
Jeton sa gjithësia, ashtu si flladi pranveror...

…E madhe është dhimbja, aq sa vetë zoti e di
Për të gjithë të dashurit tuaj, do u mungosh
Do t’u mungosh miqve, kushdo që foli me ty
Vetëm Diellza të pret krahhapur ta përqafosh...

...Vdekja e dhimbja kurrë s'kanë mëshirë
S'desha kaq shpejt, por duhet të them Lamtumirë...

## Milazim Kajtazi

### TRUNGU I GJURGJEVIKUT

O lis i vendit tim
o trim
poet e atdhetar
më fol sonte një fjalë
më ndal
këtë lot e këtë vaj

o trung i Gjurgjevikut
poet e pishtar
me rrënjë dardane
s'më prite me ardhë
e me ta shtrëngu
një herë atë dorë

më le me gojë hapur
me lotin e mallit
me lotin e dhimbjes
me lotin e pritjes

Lis i Drenicës sime
më mbushe sot më pikllime
Drenica e Kosova sot të nderon
lamtumirë në përjetësi
i lehtë të qoftë dheu mbi ty

## Miradie Ferat Avdullahi

## BAC, TË THËRRAS UNË NGA MIRËSIA

O zot, ç'është gjithë kjo ngrysi,
mos dielli nuk bën dritë,
a mos kanë filluar të verbohen sytë  e mi?!

Ah, jo, jo! Më vie një zë si nga qielli,
sot një zemër së rrahuri ka ndaluar,
nga dhembja nuk lëshon rreze dielli!

Gishtërinjtë më ngrin,
nuk e mbajnë as lapsin dot,
po as zemra fjalën lamtumirë
nuk mund të pranojë ta thotë!

U nda nga ne një shpirtbardhë,
një poet, simbol pafajësie,
zemërmadh, fisnik e bujar
u bë Yll përjetësie!

Tash i qetë të pushosh Baca Adem,
se me Engjellushën Diellzë je takuar,
neve shumë vepra në kujtim na le
kurrë për të mos u harruar!

O dhe i At-Mëmëdheut-Dardani,
në gjirin tënd tash i qetë yt bir fle,
se të deshi për së gjalli e të këndoi me dashuri,
ti kujdesu të lutem shumë për të!

Oo, zgjohu Baca Adem, çeli pak ata sy,
shih sa shkruajnë e qajnë miqtë për Ty!
Zgjohu, zgjohu o Baca i madh,
lexo e dëgjo dhe nga unë pak fjalë!

Po, o Bac Adem, shkruaj fjal, malli,
le të dridhet nga to dhe mali,
le të dridhet toka që tash të mban në gji,
se në shpirt kemi dhembje po dhe krenari!

Ooo, zgjohu o Bac, zgjohu, po të thërras unë Mirësia,
Zgjohu shih sa të deshën e të duan miqësia!
Do të kujtojmë me mburrje e krenari,
për jetën e veprën e ndritur që le Ti!

## PËR DITËLINDJEN TËNDE

Kaloi dhe një tjetër vit
erdhi përsëri kjo ditë
që kur ti o vëlla e mik, ike n'përjetësi
na le në dhembje por me krenari

O Baca Adem merr përdore Diellzën-engjëllushë
dhe Ibrahim Ibishin që atje është mes jush
shëtit parajsës në kërkim
Gjakush Tanën ta gjeni për urim

Bashkë me Lije e Dikun të gjithë tok
t'ia uroni ditëlindjen që ka sot
ia përcjellë o Bac Ademi urimet dhe nga ne
se të gjallë n'kujtimet tona jeni sa t'jemi mbi këtë dhe

## Musa Jupolli

# BALADË NË KOHË

Ah! Adem Berisha
festival i tërë poetik
para letrave me poezi
në interpretim të vargut
nota bashkëkohore
jeta e tij

Poeti e ka vështirë
të flas për krijimtari
Adem Brisha
në biografi Atdhé
misteri i gjeniut
ese i ndjeshmërisë

Pilot i vargut
~~~ n' harmoni
pena e tij

Adem Berisha
poeti ynë
në aventurën e bukur
të poezisë
pranverorë i Dardanisë
në thirrje të Shqipërisë!

***Paris,2012***
~~~

## Myrteza Mara

### KUR IKIN POETËT

Mos qani
për poetët,
kur marrin udhën e Parajsës,
mbi shtratin e ndezur
të ëndrrave rrebele!
Mjaftojnë
lotët e tyre të dashurisë,
mbi buzët e plagëve të botës...
Lavdisë dhe këngës
nuk i shkojnë lotët!

---

Nga dhimbja për vdekjen e poetit Adem Berisha-Gjurgeviku, autori dërgon këtë poezi në vend të fjalëve ngushëlluese.

## Ramadan Xhinovci

## T'PATA MIK E VËLLA ADEM

(Në përkujtim të Adem Berisha-Gjurgjevikut)

T' pata njoh veç vizuelisht,
po shpejt u bëm miq e shok,
lajmi i hidhur i vdekjes tënde,
sa keq mua m'tronditi n'kokë.

Sa e kobshme ishte ajo ditë,
kur Ti u ndave nga kjo jetë,
lot rrëke nga sytë m'shkuan,
si t'pajtohem me këtë t'vërtetë.

Unë të njoha si burr të fort,
me këshilla t'urta prej miku,
gjithmonë shpërndaje dritë,
...Ti o Adem Gjurgjeviku.

Të patëm poet e fjalë urtin,
vargu yt si mehlem shpirti,
jetës t'bukur Ti i këndove,
si Naimi, Mjeda e Çajupi.

N'Gjurgjevik u linde e u rrite,
n'histori si një vend trimërie,
për këtë tokë, për Shqiptari,
kanë dhënë jetën si u ka hie.

N'gjysmë të rrugës t'mori mordja,
kur askush këtë nuk e ka pritë,
për Prishtinë kishe marr rrugën,
ishin shokët atje duke të pritë.

Asnjëherë fjalë e besë nuk theve,
çka premtove n'fund e ke qu',
"me fjalë t'burrit kurr nuk luhet",
një herë Ti m'kishe thënë mu'.

Ti asnjëherë  nuk u korite,
as n'familje, as ndër miq e shok,
Gjurgjevikut, kësaj shtëpie t'madhe,
i'a ngrite namin për jetë e mot.

Të kishim mik edhe vëlla të madh,
në rend të parë gjithë t'kemi pasë,
nuk e kishim vështirë kur gabonim,
t'kishim Ty, n'ndihmë me na dal.

Të kishim vëlla edhe krah të djathtë,
tash pa një krah tanë kemi mbetë,
s'kemi nga kush më këshilla t'marrim,
më vargun tim nuk ka kush e "kreh".

Pusho i qetë atje, Ti o Adem vëllai,
atje në Parajsë ku Zoti vend të dha,
s'munde Djellzën vetëm me e lënë,
edhe n'atë botë Ti na i shkove pranë.

Korrik, 2012,
Heigenbrücken

## Riza Çato

### NGELE BIR I PERËNDISË

*(Kushtuar poetit, mikut, Adem Berisha)*

S'di çfarë t'ju them, jam pikëlluar,
M'u nda nga jeta një mik i mirë.
Me lot në sy jam duke shkruar,
Për Bac Ademin : U prehtë i lirë!

Ky lajm i kobshëm më trokiti,
Si një rrufe në ditë me diell
Sa vetë natyrën e mërziti,
Veç re e shi ka ai qiell.

Na njojti pena, na miqësoi,
Sa s'e besoja vdekjen kurrë
Ai poet veç vargje shkroi,
Midis kufijve ngriti urë.

Kjo ndarje erdhi krejt papritur,
Si ky rrebesh në fund pranvere,
Po vdekja Bac ty të ka ngritur,
Si një shqiponjë midis reve.

Ndaj rri mendueshëm brënda vargut,
Rënkoj, gulçoj, qaj si fëmi
Hej Bac Ademi! Qesh pak së paku,
Si vargu yt plot mirësi.

Kjo dhimbje, lehtë s'ka për të ikur,
Mbi shpinë më rri si mal i lodhur
Po jetën tënde krejt të ndritur,
Ta ndriçon vargu i kudondodhur.

Ti re viktimë e fatkeqësisë,
Atje qe e thënë ti mbyllje sytë
Do ngelësh bir i Perëndisë,
Veç unë si ty s'gjej dot të dytë.

## Sabit Rrustemi

### PASURI E PASOSSHME

*(Si ngushëllim për bacën Adem)*

miku im i urtë
vdekja na mpiu përpak
na la pa fjalë

lotët se si na u rishfaqën
mbrëmjes së vonë
si grumbuj thneglash
varg e varg

ti u rizgjove
nëpër dashurinë tonë
ashtu i qetë
krejt i paqtë

me pak fjalë
na i more zemrat
për t'satën herë

kur na the hapur
pa më t'voglin hezitim
jeni ju
imja pasuri

i tillë ishe
i tillë mbete dhe tek ne
me njerëzinë tënde
atë pasuri të pasosshme
nën dhe e përmbi re

## Sevëme Fetiqi

## PA TITULL

Çatitë e kulmeve të kësaj nate
edhe atje edhe këtu në vetmi mërgimtare
pikojnë shi të dhembjes për ty, o baca Adem
si ta quajmë këtë ditë maji
kur pikëllimi na e humbi kuptimin e jetës
Na i le vargjet pa titull
Sytë na i mbushe me lot
Por zemrat krenare
Që të patëm mik dhe vëlla
s´na the as lamtumirë
në rrugëtimin tënd të amshuar
na le të gjithëve ta ruajmë
kujtimin për veprën tënde
që kurrë s ´do të vdes

## Skënder Braka

# MELODI TË PËRGJAKURA KËNGËSH…..

*Të paharruarit, mikut tim Adem Gjurgjeviku*

Në heshtje errësirës, i vetmuar shkoj ngadalë
Përbrënda trupit tim të ndrydhur hapur një tjetër varr
Me shpirtin e përthyer gjer larg dëgjoj një këngë
Dhe thonjët e gjishtërinjëve kafshoj fort me dhëmb
Gjithë qënien time, vajit lëshuar dua t'ia lë
I kërrusur prej kësaj dite, nën një melodi të trishtme
Deri në rrënjë flokësh dhimbja më përshkon
O melodi e përgjakshme pse shpirtin ma kafshon?
Përzier nën lot malli shikimi mi i tretur
Buzëve që më dridhen, e ëmbla fjala jote mbetur
Më gjëmojnë mendimet prej k'tij lajmi më të zi
O melodi, e përgjakur, që ditës ia çave zemrën
Përtej vdekjes tërhiqu, lërmë një çast të lirë
Nën përlotjen time të puth k'të burrë të mirë
Se sot e nëpër vite do t'më mungojë një zë i ngrohtë
Do t'më mungojë një burrë, një Atë, një Zot
Melodi të përgjakur më ndjekin…
më ndjekin e s'më lënë të ec. ….
Oh … gjer larg në Rahovec

## Suzana Zisi

## BACA IM, ADEM BERISHA...

Baca im, Adem...Nuk arrij të besoj që TI s' je më në jetë
Jam duke thërrmuar lot të hidhur, teksa sjell në kujtesë
çdo sekondë të pranisë tënde tek unë...

Të hënen mora librin që më kishe postuar, në të cilin ti
më shkruaje:
"Kujtoje Bacën Adem edhe kur të mos jetë..."

E parandjeve "ikjen"?

Ti do më prisje në Prizren në 9 qershor tek "Drini
Poetik". Harrove???
Ashtu siç më prite vjet teksa më mbulove me atë
vështrimin atëror përplot me dashuri dhe respekt.
Ashtu siç më prite në 4 maj 2011, në Prishtinë së bashku
me Agim Metbalën dhe Xheladin Hamzën.

Më sugjerove që të bëja promovimin e romanit në Prishtinë duke më thënë: "Suzanë, ke shume miq, mikesha që të duan në Kosovë".

Më ftove të vija në Rahovec. Harrove???
Do pinim nga një kupë vere dhe do bisedonim si ati me bijën.

Bacë i dashur, ky nuk është mort...më duket lojë
Ëndërr e hidhur...
Ngrihu prej arkemortit dhe frymo, buzëqesh, thuaj që je ende këtu...shkruaj dy fjalë...për ne...

E kam të gdhendur në zemër një prej mesazheve tua të fundit:

**Adem Gjurgjeviku**

"Oj Suzanë, po si të kam o bac?. Kam kënaqësinë dhe gëzimin maksimal të kuptoj për gjenjen tënde të mirë në çdo aspekt po edhe suksese në çdo segment të jetës tënde. Për besë më ka marrë malli shumë, mbresat tuaja nuk mund të mos lënë pa dashuri e mall ata që të njohin mirë dhe kanë pasur fatin të të takojnë. Unë kryesisht mirë, po kërkoj një ilaç por kurrsesi ta gjej, nuk di, as miqtë më të dashur nuk po arrijnë të ma gjejnë: TË ZHBËJ PLEQËRINË/ hahahahahah, ti mos u nxito, freno me të dyja këmbët dhe vetëm

vendnumëro, hahahaha. Të do shumë e pakufi i yti baca Adem. Mirëmbetësh e mirë të vazhdosh.

Ti nuk munde ta presësh pleqërinë i dashur Bacë...
E gjete ilaçin...?
Apo...të gjeti "ilaçi'...?

Nuk di nëse ka një Zot apo një Parajsë diku...
Por, di që në një tjetër dimension, TI, je duke u trishtuar që me ikjen tënde hidhërove zemrat e familjarëve dhe miqve...

Të dua shumë edhe aty, NE DIMENSIONIN TËND TË DHIMBJES DHE DASHURISË SË PËRJETSHME..."

Suzana Zisi
Gjirokastër
16. 05. 2012

## Shaban Cakolli

### JE BËRË DRITË, RRUGËTON ME NE

(ADEM BERISHA-GJURGJEVIKU)

Lindjen e pate me gëzime
e krisma pushke
jetën të vështirë e pate
por kurrë, nuk u kërruse.

Ec, e ec, nëpër furtunë
në fëmijëri, u bëre burrë
kur dritën donin të na e shuanin
regjimi pushtues
u bëre mësues.

Çdo ind e shkrive
me mund, për këtë vend
u përballe, para hordhive
me shpirt e me penë.

Vuajtjet, shqiptarisht
vendimet, mençurisht

i shquar për kuvend
i zdërvjellur në letër
e penë
BACA ADEM

I dashur
ia kaloje çdo miku
i kalitur
O burrë Gjurgjeviku.

Kombin, shumë e doje
sa bukur i vargëroje
"Krenari e Pikëllimin"
Sikur të e vargëroje me Naimin
"Lulja la Lulishtën"
Sikur të e vargëroje me Fishtën.

Për kujtim, së fundi na e fale
përmbledhjen "Përballje"
Një mbishkrim në te, na mbeti brengë
"Kujtojeni Bacën Adem, kur më nuk do të jem"!

E me atë brengë, errëm e ngrysem
në vegim i shoh: Ademin e Fishtën
nën një fryt ulliri
i shoqëron Naimi
me një dritë qiriri.

Shkruajnë, ligjërojnë
i bëjnë lutje Zotit
për të mirat
e Atdheut dhe kombit.

I dashur vëlla
i çmuar mik
u shndërrove në dritë
ndriqove rrugën
të rrugëtojnë breznitë.

Të jetojnë veprat
të jetojnë fjalët
Baca përtrihet
Baca ringjallet
te çdo shqiptarë
me zemër miku
jeton i gjallë
ADEM GJURGJEVIKU.

## Shadije Hotnjani

# MBETËM PENG I NJË MALLI

*Bacës Adem, në kujtim të përjetshëm*

Sa rëndë tingëlloi kumti
-Baca ka ikur pa lamtumirë!
Dhe ne mbetëm fjalëndrydhur
Mbetëm peng i një malli të ndryrë

Është fjalë e hidhur
A ëndërr e keqe po përfton
Këtu ka një mes të mëdyshjes
Sa dhimbshëm kjo ditë po mbaron

As vargu që pikon gjak
As fjala e kushtrimit për liri
As kënga për trimat e atdheut
Nuk ngushëllojnë shpirtin mbështjellë në zi

Vërtetë ka ikur baca
A tallen sot yjet me ne
Kur vargu i tij burrërisht
Na përshëndet pa ia nda

## Shyhrete Ahma
(Shpresa Besa)

### DHIMBJE....

Dhimbje plagësh zemra Juaj duroi
humbja e mbesës ishte tmerr
as një gjë nuk Ju ngushëlloi
kur shpirtin Tuaj vuajtja e ther.

Humbje pësuam të gjithë ne
ishte luftë uragan e tërmet
por ne paqe Juve Ju plagosën rëndë
kur Diellëza iku n'parajsë, e shpresa Juaj u tret.

Lotët e derdhur ishin ujëvare
as një shami s'i mbante dot
thonit se te Diellza Juaj do shkoje
a nuk menduat se do shkonit mu sot?

Sa dhimbje la pas...a nuk e dinit?
zonjës Qerime ia këpute damarët
fëmijët tu do mbajnë amanetin
të jenë të fortë, mu si të parët.

## EDHE KUR MË NUK JE!!!....

S'kam imagjinuar ndonjëherë në Jetë,
s'e n'botë ka njeri... kaq shumë n'zemrën e Tij mirësi të ketë!
dashuri e respekt ke shpërndarë ndër miq...
që të duan e t'kujtojnë...EDHE ME KUR TE MOS JESH!

Por...përse o Zot e ke shkruar kështu?
përse të mirët i merr me vehte?
përse zemrat e bukura që kanë veç mirësi,
përse mikun tonë të madh... në gjirin tënd e more?

Veprat madhështore të shumtat i le pas...
dhimbjen e madhe që pate, e more me vete
e lotët që derdhe për Diellëzën s'u thanë për asnjë çast,
pushoni të qetë së bashku...n'parajsën e përjetshme!

Por...njerëzit -miqtë që të deshën, akoma të duan
shpërthejnë me dhimbjen e tyre nga zemra
asnjëherë s’kanë për të t'harruar....
se dikur mbolle dashuri, ...për të t'kujtuar!
EDHE KUR MË NUK JE!!!...

## Tonin Nikolli

### S'KAM LOT...

*Bacës Adem Berisha, Gjyshit të jashtëzakonshëm!*

Mëngjes i rremë
I pavërtetë
Qiell i plumbtë
Bien retë.

Vizione malesh të largët
Rrezuar në tymnajë
Sythe që vyshken
Lule të paçelura
Vaj!

Ti ke vdekur!
Dhe unë s'kam lot,
Të të qaj...!

## Vera Kurti

## PA TITULL

-:(
Të njoha e nuk të njoha,
Të njoha më shumë nga ç'njihet njeriu,
I tillë ishe miku im, ADEM GJURGJEVIKU,
Njeri i përbërë plotësisht prej NJERIU..!
Vitet do të ecin, e me to edhe unë!
Ju dhe NJERIU që unë njoha,
Me mua do të ec gjithashtu..!

## Viktoria Xhako

(Zhorzh Sand)

# DIÇKA DO T'U MUNGOJË AGIMEVE

*(Të paharruarit Adem Berisha)*

Dhimbja, peshë e rëndë m'i kërrusi supet,
Lotët kristale më ngrinë në sy,
Fjalën "lamtumirë" ma shtrëngojnë buzët,
Si mund të vijë mëngjesi pa ty?

Kështu më të mirët na dalin nga jeta,
Të qetë, të heshtur, pa fjalë, pa zë,
Agimet e reja nuk janë më, të kaltra,
Diçka do t'u mungojë sot e gjithnjë.

Ti ike buzagaz me shpirtin mbushur plot,
Por mos mendo se errësirë le nga pas,
Një pjesë të zemrës sonë ke marrë me vete,
Atë më të mirën që do na dhembë të gjithëve bashkë!

## Viola B. Zogu

## JO KJO NUK ËSHTË E DREJTË !!!!!!

I them Zotit ndal dhe na shiko,
I them Zotit drejt na gjyko
I them merri këta lot e bëj gur
I them të lutem nuk kanë te ndalur kurrë!

I them Zotit pse m’i merr njerëzit e mi
I them Zotit pse më len të jetoj në vetmi!
I them mjaft plagose këtë zemër të shkretë
I them mjaft vuajta në këtë jetë!

I them Zotit pse s'më more mua, apo s'të duhem?
I them Zotit mos vall vetëm për të vuajt unë ruhem?
I them Zotit më fal për lotët e për këtë mërzi!
I them Zotit Adem Gjurgjeviku ishte një nga njerëzit e mi!

## PËR TY !!!

.

Ku të kam o Baba Adem
Përshëndetje desha të të them
Po ku je o shkrimtar historik
Më ka marrë malli për ty o mik.

Po ku je o burrë bote
Erdhi nga kurbeti bija Jote
Ngrihu se dua të të shoh
S'të kam parë ka shumë kohë.

Erdha t’i dëgjoj këshillat tua
Ke harruar të më thuash bija ime të dua
Më ka marrë malli më thuaj një fjalë
Ndoshta të kam mërzitur t'lutem më fal!

## Xheladin Hamza

### KUSHTUAR ADEM BERISHËS

*(Akrostik)*

**A**të ditë yjet më të shndritshme ballin ta stolisën miku im
**D**ritë e syve tu spektra ngjyrash shpërndanin në çdo anë
**E** këmbët në ecje të numëronin çastet e fundit të jetës
**M**ë frikësove me atë bukuri hyjnore në atë moment or miku im

**B**renda teje lulëzonte një filiz që mezi priste të lulëzojë
**E** ta rifillojë një jetë tjetër sërish në parajsën e shumëpritur
**R**igë e shiut përzihej me lot nga sytë e tu të lodhur
**I** këndoje me zë elegjisë lamtumirëse kësaj bote të brishtë
**Sh**ikimi nga sytë e tu xhavahirë shikonte diku thellë në horizont
**Ë**ndrrat e jetës vraponin njëra pas tjetrës se ishin të fundit
**S**ot ti fillove një jetë të re bash aty ku me duar të hapura ..... të priste lulja më e dashur që kishe - DIELLËZA E BARDHË!

## A TË DHEMB SHPIRTI MIKU IM

(Akrostik)

**A** të dhemb shpirti edhe ty miku im?
**D**egë pjesëve të mushkërisë së mbetur
**E** frymojnë aromën e kësaj bote
**M**bi të cilën kalbemi unë e ti...

**B**otë ku dhembja grithë çdo damarë
**E** unë të shikoj në sy dhe qaj heshtazi
**R**ënkojmë - unë nga infarkti e ti nga kanceri
**I** japi vetit kurajo për jetën në vazhdim
**Sh**ikoj fytyrën tënde aty shoh zbehjen time
**A** të dhemb shpirti edhe ty miku im?

**13. 06. 2007.**

## Xheneta I. Jetishi

### NGUSHËLLIM PËR VETEN!

Një takim i papritur...

...pritje e padurueshme për takimin e dytë.
Dhe një fund për të mos pritur kurrë më.
Takim i fundit,
Fjalë të ëmbla rrjedhin poshtë lumit.
Të thashë se jam shumë pesimiste,
U bëre nervoz,
U ndjeva keq.
Thashë do bëhem realiste.
Sa fort doja të të ngushëlloja për Djellzën.
Të bëra ftesë...
...të më bëhesh gjysh,
Je arsye pse e dua jetën.
Oooj modesti,
Po ku e gjete vdekjen?!!!

Pritmë gjysh...
...se edhe unë do të vi...
...do vi tek ti.
Të kërkoj ca fjalë,
Të më mbash ligjërata...
...ooo këshilluesi im.
Të kam vënë në rend të parë,
Tek lista e modeleve të modestisë.
Emrin tënd çdo kund e mbaj.
Zërin tënd e dëgjoj,
Në çdo qoshe të shtëpisë.
Pusho në paqe GJYSHI ADEM.....shihemi në Xhennet.

(Xh.J. 15 Maj 2012)

## Xhevahir Gjonaj

LAMTUMIRË MIKU IM ADEM BERISHA

SHPIRTI YT U PREHT NË PAQE..!!

Kjo jetë është sa një derë në tjetrën
si lulja që vyshket pa i marrë erë
si fjala që mbetet përgjysmë
si rrufeja që bie hap e mbyll sytë...
Askush nuk është më e afërt se vdekja
lum ai që n'këtë jetë shikon punët e veta
lum kush largohet me erëz e me nder
se emri i tij nuk nuk harrohet asnjëherë...

## Ymer Berisha

## LISI I MADH I GJURGJEVIKUT

*IN MEMORIAM*

Ku je nisë o burrë i dheut

LAMTUMIRË

Lamtumirë oj toka ime
Ku mbi ty e vura kokën
E tash si krevat do të më shërbesh
Se do të shtrihem mbi ty

Lamtumirë,

Lamtumirë kasolla ime
ku në ty u linda e urrita
e u bëra burrë,
e u bëra plak

tash po shkoj
e po të lë
po të lë oxhaku im

ku gjyshi e baba më tregonin
legjendën për mbretërinë Dardane

Lamtumirë
shqiptari

lamtumirë
shqiptari se ty po të lë më së keqi
o kombi im i përvuajtur
e kurrë i përkulur
po të lë

Lamtumirë
miq, shokë e jarana

Lamtumirë atyre
që nuk arrita t'ua shtrij dorën
e t'ju marr në grykë
e t'ju shtrëngoj
e t'ju lë amanet...
t'ju lë amanet tokën,
e kombin tim

Lamtumirë
Kosovë.
Se po shkoj te IBRAHIM RUGOVA,
SALI ÇEKU PO MË PRET
ZAHIR PAJAZITI
ATJE DO TA TAKOJ EDHE ADEM JASHARIN
E BACËN HAMZË
LAMTUMIRË JUVE QË PO JU LË
LIRIA DHE BASHKIMI KOMBËTAR
MBRETËROFTË.
LAMTUMIRË SHQIPTARIA IME.

## Anonime

# DIELLI I GJURGJEVIKUT

*(Poetit Adem Berishës që vdiç aksidentalisht)*

Këto ditë
u dëgjuan dhembshëm
rënkimet e përvajshme:
Të vendlindjes!
të shkrepave,
të lisave,
të shpezëve,
që ishin thellë
në shpirt t'mikut!
Fytyrëçelur
e zemër krenar,
ku endej
i palodhur
çdo ditë rresht,
heret n'mëngjes,
i qetë, si sfinga
e plot mall,
Dielli i Gjurgjevikut!

---

Përkundër përpjekjeve të shumta nuk identifikuam autorin e kësaj poezie. Megjithatë e vendosëm këtu me kërkesën dhe dëshirën e shumë miqëve dhe krijuesve.

# III
# HOMAZHE
# DHE KUJTIME

**Prof.dr. FATMIR TERZIU**
**Krijues e studiues-Londër**

# NJË FJALË PËR DHIMBJEN

Sot, derisa bëheshin promovim pesë libra të Riza Greiçevcit, organizatorët, recensenti i librit, i mirënjohuri i letrave shqipe, Xheladin Mjeku dhe shumë miq, prisnin që në mesin e tyre të vinte edhe Adem Berisha-Gjurgjeviku, fati e deshti që ai përgjithmonë të ndahet nga jeta. Xheladin Mjeku ishte recensent i librit të tij të fundit, që e botoi këto ditë dhe ishte vërtetë një mik i sinqertë.

Nga dhimbja për këtë humbje bëri këtë shkrim dhe e nisi edhe në adresën time. Nuk kam patur rastin ta kontaktoja të ndjerin, por nga fjalët e z Mjeku, konsideroj dhimbjen për njeriun e penës. Di vetëm se është prej familjes se heroit të madh Sadik Ramës nga Gjurgjeviku dhe po ashtu edhe ky kishte tipare të një patrioti të devotshëm. Me këtë rast i shpreh ngushëllimet familjes, miqve dhe gjithë dashamirësve. E ndërprera udhëpenë e tij qoftë një paqe me shpirtdhimbjen, një arsye më shumë që vepra e tij të kryejë përjetimin.

15/05/2012

**KEZE (KOZETA) ZYLO**

# LAMTUMIRË POETIT TË KOSOVËS!

*(Një pëllumb Paqeje në postën time)*

Sot nën një qiell të vranët dhe me vesë të butëz shiu duke u kthyer nga puna, para se të hapja portën e shtëpisë mora postën time. Ndërmjet letrave gjeta një zarf të ardhur nga Mëmëdheu ynë i dashur, nga Komuna e Rahovecit, Republika e Kosovës. Kishte ardhur si një pëllumb paqeje duke fluturuar mbi Atllantik libri me poezi nën titullin "Përballje" me autor z.Adem Berisha, botuar nga shtëpia botuese shtypshkronja "Berati" Prizren. Të parin zarf që hapa ishte pikërisht kjo dhuratë e bukur me dedikimin brenda nga vetë autori. Ai midis të tjerave shkruante se këtë libër jua dhuroj miqve të mi të shtrenjtë Kozetës dhe Qemalit. Dhe në fund vazhdonte se: "Kujtoni xhaxhi Ademin edhe atëhere kur nuk do të jetë"...

Sa shumë më trishtoi kjo frazë, ndërkohë shfletoja me një frymë faqet e mbushura me poezi me tematikë të ndryshme. Ndalova në parathënien e librit shkruar mjeshtërisht nga shkrimtari dhe kritiku i mirënjohur

z.Xheladin Mjeku i cili me penën e hollë analizonte: *"Në çastet kur po përballoja rrugëtimin plot befasi dhe retushime të reja estetike në poezitë e "Përballjes" para më qëndronte trinomi enigmatik i Adem Berishës. Ai vinte si poet, rapsod dhe si vështrues i kujdesshëm ngjarjesh me elemente të dëshmitarit të kohës, që vepron me ngulm në skalitjen e gurit të kalasë poetike të tij dhe që shpërthen si vullkan, në të shumtën, plot mllef e dhimbje"....*

Por ndërkohë që lexoja e lexoja poezitë po hapja internetin t'i shkruaja falënderimin dhe mirënjohjen për këtë dhuratë të bukur të ndjerit Adem Berisha që më kishte dërguar prej Kosove, po papritur gishtrinjtë e mi ngrinë në tastierë, m'u duk vetja në një ëndërr të tmerrshme kur lexova e rilexova e përsëri e rilexova shkrimin homazh nga z.Xheladin Mjeku botuar tek gazeta e mirënjohur në online "Fjala e Lirë" me botues shkrimtarin z. Fatmir Terziu.

Shkrimi homazh më solli ndërmend vargjet e para nga poema e Pitagorës i cili thote: "Ndero zotat, ndero të vdekurit, ndero prindërit!"

Unë jam shumë e bindur se ikja e tij e beftë do t'ju mungojë gjatë shumë miqve, njerëzve të letrave që e deshën dhe e respektuan aq shumë, ngase vetë poeti iu kishte dhënë pafund respekt e mirësi. Të nderosh të ikurit është detyrë, është ndjenjë njerëzore, çdokush fisnikërohet. Ndodhem para dy "përballjeve" ndonëse krejtësisht të ndryshme, e para me librin e autorit me titull "Përballje" dhe e dyta me përballjen e lajmit të kobshëm të ikjes së autorit larg në botën e përtejme...

Autori qysh në ngjallje nuk e kishte frikë vdekjen ai e çmonte atë si pjesë të jetës biles dhe më shumë dhe ja si shkruan: *"Gjallë as i vdekur nuk ndahem nga ti/ vetëm në*

*ty dua të prehem në varr!/ I tëri ai dhè që do të kem përmbi/ nuk është vetëm dhè/ është më tepër se ar"!...*
Luftove Bacë Ademi, luftove me trimëri për Kosovën që e deshe aq shumë, luftove bashkë me familjen tënde patriote, dhe jam e sigurtë se ke ikur i qetë ngase i keni lënë vetë me shkrim në "Poemën e Lirisë" : ...*"nëna m'i mësoi ato që s'i kisha ditur/ më e rëndë thoshte është robëria se vdekja/ për ditë të sotme biro, të kam lindur e rritur'/...*
Ike Bacë Ademi dhe do të ndalosh atje ku të pret Diellza mbeska jote e ikur tragjikisht, një lule e bukur që la lulishten... Ike në këto ditë të bukura Maji ku lulet do të rëndohen nga kripëza e lotit të lexueseve të panumërt që të çmonin dhe të vlerësonin aq shumë.
Rahoveci do të hedhë supeve shallin e zi për humbjen e një zëri të veçantë poetik në Gjyrgjevik, por jo vetëm kaq...ngase brenda librave të tu gjithmonë gjen gati –gati vargje të shenjta për Kombin tonë të përbashkët dhe ti digjesh plot zjarr për të: *"Atë e Mëmë të vetëm të kam/ ndaj të thërras plot mall o At-Mëmëdhe!/ Me gjak të kem larë pëllembë për pëllëmbë/ asgjë përveç teje nuk ka më të shenjtë për ne"!*
Me poezinë tuaj ju keni ngritur një bibliotekë modeste të prushtë që ngroh me dashurinë e një biri të përulur ndaj Atdheut. Vargjet do te jenë si përskuqje e lules bozhur me metafora të lyera e diell Kosove.
Pranë qiparisit do të ulen butë – butë dhe zogjtë shtegtarë, pëllumbat e paqes me pendë të mëdafshta për të të dhënë lamtumirën e fundit të mërgimtarëve që s'të ndodhen dot pranë për një dorë dhe...
Ne nuk të harrojmë poet, nuk të harrojmë kurrë, erdhe bashkë me vëllain tënd prof.Berisha dhe familjen që nga Kosova në Muzeumin Kombëtar në Tiranë për të marrë pjesë në promovimin e librave të mi, viti 2010. Ishte një

bashkim vëllazëror midis nesh, ishte një bashkim që ju e ëndërronit pakufi me Shqipërinë, Kosovën dhe të të gjitha trevave të tjera. Brenda vargut tuaj ka ngritur folenë bashkimi i Kombit dhe jam e sigurtë se dhe në botën e përtejme do të pëshpërisësh amanetin: Bashkohuni! Është amanet me shpirt të bardhë, është amaneti i një pëllumbi paqeje të Lirisë, që s'tretet kurrë, ndaj prehu i qetë miku ynë prej Kosove!

Të rëntë dheu lehtë!
Lamtumirë poet!
15 Maj, 2012

**Prof. dr. MURAT GECAJ**
**publicist e studiues-Tiranë**

# "MONUMENT LETRAR" PËR ADEM BERISHËN-GJURGJEVIKU

Më 21 qershor 2012, u takova përsëri në Tiranë me mikun e kolegun e respektuar Xheladin Mjeku. Ne jemi takuar edhe në raste të tjera, në kryeqytetin tonë. Dhe temë e zakonshme e bisedave tona kanë qenë e janë botimet e ndryshme. Por lidhjet tona i kemi të pashkëputura edhe përmes internetit. Kështu, në prani dhe të kolegëve botues Viron Kona e Bashkim Saliasi, përsëri bisedat tona u sollën rreth kësaj teme të përhershme. Ndër të tjera, ne kujtuam me nderim të veçantë edhe poetin e shkrimtarin e paharruar Adem Berisha-Gjurgjeviku, i cili u nda përgjithnjë nga jeta, pak kohë më parë.

Kur e mësova këtë lajm të hidhur përmes internetit, menjëherë komunikova me Xheladinin dhe bëra një ngushëllim për familjen e kolegët. Me atë rast, por edhe më qartazi sot, Xheladini më shpjegoi se atë ditë Ademi po udhëtonte, nga Rahoveci, për në Prishtinë. Me vete kishte marrë edhe një çantë të mbushur me libra. Se për të, ashtu si për çdo autor tjetër, ato ishin një pasuri e paçmuar. Pra, dëshironte që ta ndante kënaqësinë e tij me kolegët, duke përuruar një libër të ri. Siç më tregon tani Xheladini, ky i kishte bërë hyrjen, duke e vlerësuar lart krijimtarinë e tij.

Por..ah, erdhi një çast tragjik e vdekjeprurës për krijuesin atdhetar Adem Berisha-Gjurgjeviku! Nuk e di nëse ai pati kohë të mëndojë  për shumçka. Por vetimthi, siguristh, ka sjellë ndërmend familjen, kolegët dhe njerëzit e tij të dashur. Por ai e ka shtrënguar fort edhe çantën e librave, si të kishte aty një thesar. Se me të në dorë e ndiente kurdoherë veten më të pasur shpirtërisht dhe e dinte se pjesë të  kësaj pasurie do t'ua dhuronte me dashamirësi kolegëve të tij. Nuk di hollësira, se edhe po t'i dija e t'i përmendja këtu, rikujtimi i tyre e rëndon gjendjen shpirtërore të familjarëve. Por është e saktë, se ai e humbi jetën tragjikisht, në një aksident.

Unë e Ademi nuk ishim parë as takuar ndonjëherë. Por në larëgësi na lidhte bota e madhe e letrave, e shkrimeve. Kisha lexuar vjersha të tij të frymëzuara: kushtuar traditave atdhetare, figurave të shquara për liri e pavarësi, për Kosovën dhe Shqipërinë e tjerë. Kujtoj këtu edhe poezitë e tij: "Kush ngre dorë në ty, Shqipëri!" dhe "Gjurgjeviku, si kala". Prandaj e përjetova me  dhimbje humbjen e tij të parakohshme e tragjike, pra të pa shkaktuar nga ndonjë sëmundje.

Ndërsa ndieva një kënaqësi të natyrshme, kur miku im Xheladin më tregoi se një grup miqsh të tij po përgatisin një botim të posaçëm. Ai do të përmbajë poezi, skica e mendime të shprehura për jetën e krijimtarinë  e Adem Berishës-Gjurgjeviku. Për shembull, Shaban Cakolli shkroi e publikoi poezinë me titullin, "Je bërë dritë, udhëton me ne". Siguristh, aty do të jetë edhe vjersha e emigrantes kosovare në Gjermani, Shadije Hotnjani, me titullin domethënës, "Mbete peng i një malli". Rreth kësaj poezie janë bërë disa shënime nga lexuesit, duke shprehur nderim e respekt  të veçantë për Adem Berishën, për të cilin autorja shprehet se, nga humbja e tij, "shpirti është mbështjellë në zi".

Më kanë mbetur në mendje edhe disa fjalë, që i ka shprehur publikisht i biri, Agroni: *"Ditët po kalojnë pa ty, ndërsa dhimbja sa vjen e shtohet. Hija jote, i dashur baba, vazhdon të qendrojë nëpër shtëpi. Ende, çdo e hapur e derës, më bën ta ngre kokën lart e të shpresoj se do të shoh, ashtu të buzëqeshur. Çdo mbrëmje, pres deri vonë i zgjuar, që të na urosh si përherë natë të mirë. Por jo, si duket ditët e lumtura me ty, tani kanë ikur dhe ato kanë mbetur vetëm në kujtime të ëmbla, të cilat kurrë nuk do t'i harrojmë. Prehu në paqe dhe në qetësi, o i dashur Baba!"*

Pasardhësit e çdo njeriu, që ndahet nga jeta, gjejnë rrugë e mënyra të ndryshme për të ruajtur kujtimin e tij. Kështu, me raste, organizohen përkujtimore, bëhen lutje fetare, shkruhet në gazeta ose flitet në mjetet e komunikimit masiv. Por edhe i ngrihet varr, sipas mundësive monetare e bile, ndokush, i punon bust, në allçi e deri në bronx. Ndërsa unë mendoj se vlerësimi më i lartë dhe përkujtimorja më e veçantë për një figurë të shquar atdhetare e krijuese, siç është Adem Berisha-Gjurgjeviku, do të jetë botimi i një vepre letrare. Se në të do të përmblidhen ndjenja e mendime të sa e sa të afërmve, miqëve, kolegëve e dashamirësve të tij. Një libër i tillë do të jetë "monument letrar", i cili do t'u qëndrojë fort shumëvjeçarëve. Ai do të përcjellë, nga një brez në tjetrin, kujtimin dhe vlerësimin e merituar për jetën dhe veprimtarinë e tij, në shërbim të Atdheut e shoqërisë. Prandaj gjej rastin t'i përshëndes nismëtarët dhe realizuesit e këtij botimi. Ndërsa familjarëve të tij ju uroj nga zemra, që të jetojnë sa më gjatë, me gëzime e lumturi të pandërprerë dhe ta kujtojnë përherë njeriun e tyre shumë të dashur, Adem Berishën-Gjurgjeviku!
I paharruar qoftë kujtimi i tij!

***Tiranë, 26 qershor 2012***

**SHABAN CAKOLLI**

# LOTËT E NJË NDARJEJE!

*Nekrolog për vdekjen e një poeti të madh*

Kurrë nuk do të guxoja të mendoja se diçka e tillë do të ndodhë këto ditë! Eh, po ndodhë edhe kjo, pikërisht kur nuk mendon të ndodhin të papriturat. Mbi kokën time ranë vetëtima. Po flitet për vdekjen tënde i madhi baca Adem Berisha! Joooooo, jooo, nuk është e vërtetë thashë, fatkeqësisht për fjalë nuk kishte vend, vdekja e kishte bërë të vetën! Mbeta disa çaste në komë, përpëlitesha në mes realitetit dhe ëndërrës, luftoja me shpirtin tim, nuk mundesha të pajtohesha me vdekjen tënde, por para syve filluan të më bien perde mjegullash, ngushëllimet vazhdonin e vazhdonin. Pajtohu më tha një zë, fatkeqësisht baca Adem vdiq, vdekjes nuk i dihej nga se njeriu udhëton gjëthnjë me vdekjen, por nuk e di kur vdekja e nxë dhe është mirë që nuk e din.
Facebookut ja kam frikën, shpesh e pyeti vetën të hy apo mos të hy?! Sa herë hy aty klikoj me droje, ndjej diçka rrënëqethëse. Aty gjëthnjë kam marrur kumte që më dridhnin tokën nën këmbë! Aty mora kumtin për vdekjen e të madhit, vëllait, shkrimtarit, poetit e kritikut letrar Ibrahim Ibishit, Ferit Ramadanit e tash të bacës Adem

Berisha. Ah, sa kumt i vështirë, sa kisha nevojë për ndihmë shpirtërore, lotët nuk mund të i ndalja, e di se nuk ishte mirë të të rëndoja me lot këto çaste, por nuk përmbahesha dot, shkonin vetvetiu, e zemra më thoshte: Qaj sa të mundesh, se më mirë është të dalin lotët, sesa të struken në thellësinë e zemrës, shpirtit. Më fal baca Adem, nuk do të jepnim për asnjë çmim, por njeriun nuk po e pyetka vdekja, njeriu nuk po mundka të jetë përcaktuesi i fatit jetësor, njeriu qenka i pafuqishëm ndaj fenomenit të vdekjes.
Baca Adem, unë miku i juaj nuk po mund të pajtohem me shkuarjen tënde, edhe pse ti vdiqe hijeshëm në ballë të votrës stërgjyshërore, të përcollën vëllezër, miq e veprimtarë, edhe pse vdekja është tinzare, të rrëmbeu pabesisht kur na u deshte më së shumti. Nuk po mundem të pajtohem, nga se nuk munda të i bashkangjitem turmës e cila vinte nga katër anët për të dhënë lamtumirën e fundit dhe kjo nuk më liron kujtesën e pikëllimit. Ti do të pushosh përjetësisht me të tjerët që shkuan, ju bashkangjite Diellzës që aq shumë e deshte dhe sikur rënja e juaj pati të njejtin fat, do të pushosh edhe me ne që herët apo vonë do të jemi aty, vetëm një gjë po të kam lakmi: Vdiqe njëherë si vdesin burrat, për të mos vdekur kurrë, kurse ne mërgimtarët që nuk mund të ishim pranë për të thënë lamtumirën e fundit, kishim vdekur ditën që erdhëm në mërgim dhe do të vdesim sërish, kur do të na bartin mijëra kilometra, për të na varrosur ndër varret e të parëve. Ti i madhi baca Adem, ti ishe njeri i dashur, zemërmadh, veprimtar i shquar kombëtarë, poet dhe e kuptoj se Gjurgjevikut do i kenë rënë hije vranësirave që kanë sjellur lotët e shumë të dashurve tu ashtu sikur riga shiu. Po edhe ne në mërgim nuk mund të mos derdhim gurra lotësh, të qofshin të lehtë i nderuari bac. Tani na kanë mbetur librat tuaj, shihemi pa folur, por kurrën e

kurrës nuk do të heqim nga kujtesa, do të shpërndajmë veprat tuaja nëpër breza. Një gjë më rëndon, nuk do të shihemi e dëgjohemi më, nuk do të na pritë në përqafim kur të kthehemi nga mërgimi, po padyshim kur të vizitojmë varrezën tuaj do të jetë e tëra e mbuluar me bari. Do të thurim këngë të dhimbshme e vargje mallëngjyese, ti poet e shkrimtar i kombit që kurrë nuk ndalove, vazhdove rrugën e besimit në komb, miq dhe art dhe gjëthnjë besove në atë që shkrove. Ti baca Adem nuk pranove kurrë rënien, nuk e braktise muzën e frymëzimit, sepse krijuesi njihet mu aty, kur e braktisë muza e frymëzimit shihet rënia e tij. Andaj ti ishe qëndresë dhe të deshtëm e të duam të gjithë.

SHËNIME BIOGRAFIKE

Adem Berisha u lind më 03.05.1948, në fshatin Gjurgjevik i Madh të komunës së Klinës. Rrjedh nga një familje e varfër por e pastër nga ideali dhe përcaktimi kombëtar. Shquhej ndër nxënësit më të mirë pranë shkollës fillore "Zejnel Hajdini" në Ujmirë. Në shkollë ishte i dallur si aktiv i grupit letrar, dramatik dhe muzikor të shkollës. Shkollën për mësues e kreu në "Hasan Prishtina" në Mitrovicë. Ka punuar mësues në fshatrat malore: Gorozhup, Shkozë, Gurbardh të Malishevës. Nga viti 1973 ka punuar si punëtor i administratës komunale në Rahovec.

Ka botuar:

“KRENARIA DHE PIKËLLIMI" - poezi
"LULJA LA LULISHTEN" - poezi
"PËRBALLJE" - poezi

Baca Adem ishte veprimtar i shquar kombëtar, poet, njeri

i rrethuar me shumë miq. Dje më 15.05.2012, na tronditi kumti për vdekjen e tij. Adem Berisha është poeti që nuk vdes, do të kujtohet nëpër breza për jetë të jetëve. Ai kishte një dhimbje të madhe e cila e pllakoste, humbja e mbesës Diellza, e cila në moshën e njomë u shua nga një fatkeqësi komunikacioni. Libri "LULJA LA LULISHTEN" iu kishte kushtuar pikërisht asaj me poezitë e bacës Adem dhe të disa miqve që ndanin dhimbjen me të. Baca më pati dërguar burrërisht që të tre librat e tij. Sikur kishte ndjenja se po ndahet nga ne, në librin e tij "Përballje", të cilin e mora pak para vdekjes së tij më shkruante: Shaban, kujtoje bacën Adem, kur ai të mos jetë më! Baca nuk ishte i moshuar shumë, kishte vetëm 64 vjet, ngapak lëngonte nga sëmundja, natyrisht e kam pasur në kujtesë, e kam dashur dhe do ta kujtoj gjëthnjë, por kurrë nuk më ka shkuar mendja se këto ditë do të ndahet nga ne! Javë më parë baca Adem botoi përmbledhjen e tij poetike, të tretën dhe të fundit "PËRBALLJE": Ajo çka më mundon është: Vallë mos baca kishte parandjenja se këto ditë do të përballej me vdekjen? Sipas shkresës në kopertinën e librit që më dërgoi, disa bisedave kohën e fundit në facebook, unë jam i bindur se baca po parandjente këtë përballje me vdekjen! Në këtë përmbledhje baca hodhi edhe poezi përkushtuese ndaj miqve si: Këze(Kozeta) Zylo, Alma Papamihalit, Tonin Nikollit, shumë miqve ndër të cilët edhe mua më kishte kushtuar një poezi! Po ne o baca Adem, ku të marrim forcën, ku të ndalim lotin, e të përkushtohemi? Dy përmbledhjet e para të bacës Adem "KRENARIA DHE PIKËLLIMI", si dhe "LULJA LA LULISHTËN", i kam botuar komplet në gazeta, revista, faqe interneti, forume e gjetiu, sot po e botoj poezinë që më kushtove mua, po e laj me lot, po të premtoj bacë se edhe përmbledhjen e fundit do ta botoj tërësisht, do e

shpërndajë te brezat e ri dhe prore do të mbetesh në kujtesën tonë i pavdekshëm.

## KURBETI PËRVËLON
(Adem Berisha)

Për mikun që shumë e dua
e gjatë jeton në mërgim,
lotët më rrjedhin si krua
ta kem këtu, në atdheun tim.

Ta shoh në vatrën e tij,
në të dashurën Dardanë,
ku ndjen gëzim e krenari
ku shpirti i pushon,

Ku ka shumë miq e shokë,
shumë motra e vëllazëri
që kishin rënë për këtë tokë
e për të shtrenjtën liri.

Ku bukës i thonë bukë
e ujit shqip i thonë ujë,
të mos e përvëlojë malli
atje laaarg, në dhe të huaj.

Mua më mungon shumë,
e doja dhe e dua si vëlla,
është pjesë e qenies sime
krahun thyer ma ka.

Si dy vëllezër të dashur

bashkë qanim hallet tona
fatin të njejtë e kem´pasur
nuk flinim deri në orët e vona.

Me Shaban Cakollin
bashkë dua të pimë kafe,
për shumë e shumë gjëra
nuk do ngopemi llafe.

Pa e hequr me të mallin
nuk dua të shkoj në amshim
përderisa të mos marr me vete
më të mirin e të ëmblin kujtim.

Eh, po unë nuk erdha kësaj radhe baca i dashur Adem, nuk erdha, jo që nuk desha, por nuk munda, kështu është kurbeti. Mendoja të vijë një muaj më pas, por nuk më prite bac, andaj më fal, më fal, më fal, më e bën hallall baca Adem. E tani unë nuk mund të shkruaj, kam një lëmsh dhembjesh në shpirt për ty i dashur, mundem të të qajë deri sa ka burim loti në sy, nuk po të lotoj vetëm unë, po të lotojnë miq, poet e veprimtarë nga mërgimi. Ah, sa do të isha i lumtur, sikur të më qanin edhe mua si ty! Lamtumirë i madhi baca Adem, e lehtë të qoftë, i paharruar do të mbetesh nëpër breza.

**XHELADIN MJEKU**

# KRENOHEMI ME VIRTYTET ATDHETARE DHE VEPRËN TËNDE

***Lajmi për vdekjen tragjike të Adem Berishës-Gjurgjevikut ishte dhimbje e papërshkruar***

Mbrëmë biseduam miqësisht, e sot po ngushëllohemi tepër dhimbshëm. Kjo është e papërshkruar në këto çaste kur lajmi i kobshëm bie rrufeshëm në veshët tanë dhe lëndon zemrat e të gjithëve. Dhimbje kaq të madhe vështirë se kam përjetuar ndonjëherë dhe kjo më bën të kuptoj se sa e paskam dashur dhe sa na paska dashur Ai neve, kur ende pa i mbushur njëzetekatër orë nga paralajmërimi se do të takohemi në Prishtinë, na erdhi ky lajm i kobshëm. Sikur kishte një parandjenjë që të takohej me shokët dhe miqtë e tij për herë të fundit. Këtu po jap fjalët e fundit të bisedës që kishim me të para përshëndetjes së mbrëmshme, që fatkeqësisht paska qenë e fundit mes nesh:

"Nuk di Xheladin, pasi do të jem nesër aty, ndoshta do të shkojmë pak edhe në LSHK, duhet të bëj një kërkesë, një biografi të shkurtër dhe nga tre libra të titujve

të botuar,  kështu më kthyen një përgjegje. Të shohim si do të na premtojë koha”.

Dhe vërtetë nuk e paskam ditur se është kaq kohë e shkurtër për tu takuar përsëri. E sot kur të prisnim të na takoje atje në Amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Unversitare në Prishtinë, ashtu si na premtove mbrëmë, Ti paske marrur një rrugëtim tjetër për të mos u kthyer kurrë më në mesin e miqëve, shokëve, dashamirëve dhe të gjithë atyre që i deshe e të deshën me sinqeritetin prej vëllau, miku, kolegu e bashkëpunëtori të devotshëm. E dhimbshme për të gjithë. Edhe familjes do ti mungosh përgjithmonë, por kur kujtojnë veprat dhe punën tënde që ua le trashëgim  kanë me çka të krenohen që të patën, si djalë, vëlla, prind, pedagog e frymëzues për jetë e liri, që ishin idealet dhe synimi yt përfundimisht. Veprat tua të dëshmuara na bëjnë të fortë edhe neve të gjithëve, miq e dashamirës që të njohëm e bashkëvepruam për të gjallë. Të falënderojmë që nuk na le duarthatë, derisa veprat e shkruara që kemi nga pena jote do të jenë frymëzim që të kujtojmë e të përjetësojmë mesazhin që kishe në shpirt e zemër.  Patjetër do të “Përballemi” me dhimbjen dhe do të mbesim të ngushëlluar me faktin se fjala jote ishte dhe mbetet përgjithmonë udhërrëfyes i rrugës së ardhmërisë, dashurisë për jetë dhe liri. Kjo na bën ta mundim dhimbjen e madhe që ka pllakosur në zemrat tona.

Kurrë nuk do ta besoja, se kaq shpejt do të shkruaj këto fjalë ngushëlluese pas shkrimit tepër frymëzues dhe me kënaqësi që bëra për librin tënd të fundit. Nuk e paskam ditur pse ngutej ta nxirrje në dritë, por tashmë e kemi të njohur se paske pasur një detyrë tepër serioze që ta përfundosh, për të përcjellur mesazhin tënd tek ne me dëshirën që ta vazhdojmë tutje punën dhe detyrat që na presin në ngritjen e vlerave të lirisë dhe ndërtimin e atdheut. Vërtetë ky mesazh na obligon dhe zotohemi se

do të ndjejmë obligim ndaj amanetit tënd. Sa e rëndë të jap këtë shkrim ende pa e marrur nga Ti ekzemplarin e librit tënd, por ndihem krenar që të njoha, u takuam, biseduam e bashkëpunuam kaq ngushtë e vllazërisht.

Me dhembje të madhe them se ndarja jote nga ne është humbje fizike, por vepra dhe shpirtëbardhësia jote do të mbesin përgjithmonë në kujtesën tonë si mall i pashuar që obligon përfundimisht.

I lehtë të çoftë dheu i Kosovës që aq shumë e deshe dhe ia kushtove një jetë të tërë duke i kënduar për lirinë e saj. Familjes dhe të gjithë atyre që të njohën dhe të deshën, që ndiejnë dhimbje dhe mungesën tënde, ju shpreh ngushëllimet e sinqerta me bindjen se vepra dhe kujtimi për Ty do të jetë i përjetshëm.

**15.05.2012**

---

Ky shkrim u lexua në Mbledhjen Komemorative, në shenjë ngushëllimi për humbjen e mikut të madh Adem Berishës-Gjurgjevikut. Nga gjendja emocionale dhe dhimbja e autorit të shkrimit, këtë letër-homazh e lexoi Besmirë Bytyçi.

# PIKËTAKIMI ELEKTRONIK

Në vazhdim takojmë shkrimet e miqve dhe bashkëveprimtarëve të shumtë që me dhimbje e pikëllim pritën kumtin për shuarjen e papritur të Adem Berishës-Gjurgjevikut. Këto shkrime paraqesin ndjenjën, mirëkuptimin dhe forcën ngushëlluese për humbjen e mikut të tyre, duke kaluar herë si dhimbje, herë si forcë në formën e dialogut, por që gjithnjë duke realizuar një ***Pikëtakim elektronik*** për të ngushëlluar miqtë, shokët e vëllezërit gjithandej ku gjenden e veprojnë e deri në gjetjen e mundësisë për ta mbajtur në kujtesë emrin dhe veprën e tij prej krijuesi e bashkëveprimtari të sinqertë e me virtyte njerëzore. Këto shkrime-homazh kanë edhe një mision, që në përmasën e madhe e arritën efektin e tyre, duke përcjellur mesazhin e mirëkuptimit, zbutjes së dhimbjes dhe solidarizimin me familjen e Adem Berishës-Gjurgjevikut, që dëshmon se vepra dhe puna e tij kaherë kishte shtrirë krahët gjithkah mund të takohet njeriu i mirë e liridashës, të cilët edhe në ditë të vështira ndajnë pjesën e vet të pikëllimit dhe marrin guximin e përballjes me fatin.

Këto shkrime e komente nga të gjitha vendet ku jetojnë e veprojnë shqiptarët, që zhvillohen në forma të letrave ngushëlluese, në dialogje e shprehje dhimbjeje, sa me familjarët aq edhe mes vete krijon parandjenjën e një pikëtakimi për të lënë gjurmët e pashlyera për emrin dhe veprën e tij. Prandaj, të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre shkrimeve nuk bëmë radhitjen alfabetike, për të ruajtur sadopak frymën e komunikimit dhe të afrisë së pjesëmarrësve në këtë formë elektro-homazhi që u aplikua për disa ditë radhazi.

# Lamtumirë Baca Adem!



**O Baca Adem Berisha - Gjurgjeviku,**

## Po pse ike o vlla?

Aq shumë të kam rrespektuar, të kam dashur si vllaun e ti ike pa lamtumirë. Nuk bëre mirë o vlla. Para pak ditësh më shkruajte se unë do ta mundi kancerin dhe se sivjet do të pimë kafe sëbashku. Ti gjithmonë ishe me brengën dhe smundjen time. Gjithmonë më dhe kurajo për jetën ndersa vetë ike. Të paska marr malli për Diellzën dhe shkove te ajo? Të fala pra Diellzës dhe Ninelit tim atje në parajsë. Sa shumë po qaj për Ty e ti as nuk lëviz më. Zgjohu e fshimi lotët o mik e vlla Baca Adem! Mendoja që tekstin e këngës që Jubeleun qindvjeçar të Shqipërisë ta shkruanim sëbashku. Tani u bë vonë por do e shkruaj unë edhe për shpirtin tënd.

Unë nuk munda të jem aty që mbi varrin tënd ti them dy fjalë. Poqëse jetoj akoma, e poqëse do të vi në Kosovë, kam me ardhë te varri Yt për të ti thënë disa fjalë që i ruaj në zemër. Ti do ti ndëgjosh por përgjigjen do të ma kthesh kur të takohemi në botën e amshuar.

Kurr skam me të harruar. Gjithmonë do jesh në kujtimet e mia!

Lamtumirë o VLLA i dashur Baca Adem Berisha!
Të fala Djellzës dhe Ninelit!
Agimi Yt!

**Murat Gecaj:** I dashur Xheladin, familjarë të Adem Berishës! Ju dërgoj nga Tirana ngushëllimet e mia më të sinqerta për humbjen e mikut dhe njeriut tuaj shumë të dashur, krijuesit të përkushtuar për popullin e Atdheun! Vërtet nuk kam patur rastin ta njoh nga afër këtë autor veprash, por i kam ndjekur krijimet e tij, sidomos përmes faqes së internetit "Fjala e Lirë" dhe kam vërejtur forcën e penës dhe të ndjenjave të tij. U preka shumë edhe nga shkrimi i koleges Kozeta Zylo dhe shënimet dashamirëse të miqve: Fatmir Terziu dhe Edmond Shallvari. Me respekt për ju dhe paçi kurdoherë vetëm gëzime, vetjake e familjare!

Prof. Murat Gecaj
publicist e studiues-Tiranë

**Edmond Shallvari:** Ky lajm mengjesor i dhimbshëm, më preu krahët, me shastisi fare, nuk di ç'të them, kujt t'i zhdefrehem, për këtë ikje të papritur të mikut tim të dashur, Ademit. Njohur vërtet forumeve shqiptare, por stërnjohur më mirë se realisht shpirtin e tij fisnik, atdhetar, burrëror, artdashës, human. E kam ndjerë këtë shpirt sa herë mesazheve të tij aq të ngrohta, dashamirëse e vlerësuese ndaj krijimtarisë sime, kemi shkëmbyer sa herë mendime për krijimet e njëri-tjetrit. Njihja dhe ndjeja dhimbjen e pashërueshme për humbjen e mbesës. Adem i dashur, i vajte pranë o gjysh i dhembshur mbesës, Diellzës së dielltë, që aq shumë e deshe, aq bukur i thurre vargje, duke përjetësuar atë dhe veten tënde. Pse o mik nxitove, atë rrugë përpara e kemi të gjithë. Me lotojnë sytë këtë çast, trupi më dridhet, por shpirti ndjen sikur je

duke na përshëndetur, duke shtrënguar në krahë Diellzën e vogël. Udhë të mbarë i pavdekshmi Adem.
I përjetshëm kujtimi për ty dhe veprën e çmuar.

**Shpresa Krasniqi:** Me këto vargje të shkruara nga vetë Baca Adem Berisha, ju shpreh ngushëllime Familjes, Farefisit si dhe shoqërisë se gjërë të Bacës:

"Jo, unë për ju nuk jam i vdekur,
në zemrat tuaja rrënjë kam shti
Siç kam qenë, i tillë kam mbetur
tash jam lule në pavdekësi".

R.I.P Baca Adem Berisha!

SE Ç'MË MAGJEPSIN KËTO BUKURI

Në maje të një mali të atdheut tim shekullor
midis pishash që duket sikur prekin qiellin,
nën rrezet e ngrohta të diellit pranveror
vendosa sot të sfidoj edhe bilbilin.

Dua t'i këndoj këtij atdheu që më lindi e rriti
kur së pari frymova e këndova këngen time të parë,
dua të këndoj për atë që ma do mendja e shpirti,
dua të këndoj shqip e shqiptarisht se jam shqiptar.

Shikoj kreshtat përqark si ngrehina të trimërisë,
ku flamuri me shkabën dykrenore valvitej valë-valë,
ku luftëtarët trima, sot deëhmorë t'atdheut e lirisë
gjakun e jetës kësaj toke të shenjtë i kishin falë.

Se ç'më erdhi tash në mendje në këtë kodër

të këndoj edhe këngën "Më mirë në pyll se n'qytet",
atë këngë që askush s'e këndon dot si Qamili Vogël -
Ai yll i muzikës sonë popullore i paharruar përjetë.

Harrova moshën, s'e njoh sot të mbrapshtën, pleqërinë
Uji i ftohtë i kroit që kam këtu pranë më freskon e rinon
Kalit të bardhë pa fre, tash do t'i gjuhem në shpinë
të më çojë gjithandej ku shpirti e zemra më pushon.

13 maj 2012, ditë e diel. Bacë Ademi del ta kalojë këtë ditë pushimi në mal, aty përreth Rahovecit, për t'a shijuar bukurinë e atdheut të vet që aq shumë e deshti dhe e çmoi. Nuk di a e ndjeu zemra e TIJ, që kjo ditë pushimi ishte dita e tij e fundit për t'u përshëndetur me bukuritë e atdheut të tij??..Për t'u ngrohur me rrezet e diellit pranveror për herë të fundit??..E që në zemrën e tij të gulshonte gëzimi, e që pastaj të shndërrohej në bilbil e ta këndonte këngen "Më mirë në pyll se n'qytet"??....Dhe me zemrën plot mall e dashuri për atdheun, thurri këtë poezi kaq të bukur, për të qenë kjo një poezi përmbyllëse e krijimtarisë së tij artistike si poet dhe atdhetar i denj i kombit të vet.

Nuk jam poete që të shkruaj fjalë të bukura, artistike, ndoshta edhe kam gabuar në shkrim, por, JU të dashur miq, do t'më falni mua në qoftë se kam gabuar diku, se jam shum e emocionuar në këto momente, se asnjeri nga ne s'e kemi pritur ikjen kaq me të shpejtë nga kjo botë të bacë Ademit!! Dëshira ime ishte që ta ndaja këtë kujtim për bacë Ademin, së bashku me JU miq të dashur e të nderuar!!

Pusho i qetë në tokën e Kosovës martire bac Adem Berisha!!..Qoftë i paharruar kujtimi për TY!!

**Agron Adem Berisha:** Faleminderit Shpresa, këtë poezi e kishte lexuar së fundmi vetë për nder të javës së dëshmorëve në Rahovec, ku ishte i ftuar nga Kuvendi Komunal dhe OVL-ja si organizator.

**Flora Peci**: Tani që e di se bacë Ademin nuk e kemi më në mesin tonë, këto vargje më erdhën shumë të ndjera. Flm për postim Shpresa!

**Mentor Thaqi:** Ah! Më preku thellë shpirtërisht, vargje malli që shpirtin peng na e mbajnë ! Ev, ev, po na ikë java e parë pa të! Shpresë, t´falemnderit për kujdesin dhe respektin!

**Teuta Shala Qyteza:** Faleminderit Shpresa...!! E lexova me sytë e shpirtit dhe më besoni... m'u shtua rrahja e zemrës, mike!! Një poezi e tillë, sikur me porosi qenka thurur!! Paska lënë gjithë këtë dashuri për jetën, e për veten paska zgjedhur pyjet, ujin e kroit, natyrën e lirë, kalin e bardhë.... O Zot, sikur ta ndjente!!! Oh, ç'poezi!! Pushoftë në paqe Baca Adem ! I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij!

**Zhorzh Sand:** I paharruari Adem jeton në vargjet e tij dhe në zemrat tona! Faleminderit për postimin!

**Shpresa Besa:** Siç thotë edhe motra ime Zhorzh Sand, dielli i Gjurgjevikeve kurrë nuk do të shuhet nga zemra e miqve të tij...dhe siç thotë edhe motra e dashur Seveme

Fetiqi,.. Ai ka qenë diell për ne, për miqtë dhe mikeshat e f.b...që nga mëngjesi me përshendetjet e tij, e deri në mbrëmje urimet për natë të mirë....Ne të gjithë atë ditë u shokuam nga ky lajm i trishtë, dhe akoma jemi të pikëlluar, e do jemi dhe shumë gjatë...se ky njeri i mirë, ky burrë i fortë, i idealeve të tij për lirinë e vendit dhe kombit, për dashurinë e madhe të tij aq njerëzore, i cili dhuroi aq shumë për familjen dhe miqësinë...sot e për jetë do përkujtohet me shumë dhimbje por edhe me shumë krenari që patëm një diell i cili na ngrohte me fjalën e Tij të ëmbël...poezia është e mrekullueshme ...edhe Gjurgjevikut do t'i mungojë ky diell...te faleminderit Agron për postimin e kësaj poezie tepër të ndjeshme...dhe Juve z Xheladin Ju faleminderit për thurjen....e di që edhe Juve Ju mungon shumë!

**Kozeta Zylo:** Faleminderit mike e shtrenjtë Shpresa, që me aq respekt dhe mirënjohje fliste për ty dhe gjithë bashkatdhetarët që kanë komentuar. Poeti prej Kosove Adem Berisha do të ngelet i përjetshëm në zemrat tona, që e njohëm dhe komunikuam deri në momentet e fundit. Vargjet e tij janë gdhendur në kujtesën tonë. I paharruar Bacë Ademi!

**Gëzime Sinani:** Faleminderit mikja ime e mrekullueshme Shpresa. Akoma e kam të fresket në mendje dhe zemër këtë gjëmë të largimit nga jeta të Bac Ademit, njeriut që si ju dhe unë e kisha mikun tim të veçantë, që asnjëherë s'harroi të më merrte në telefon... Më mungon miku im....Pushofsh në paqe...

**Alma Papamihali:** Faleminderit e dashur Shpresa ...Gjatë këtyre viteve që shkruhemi në Fb...lajmi i

humbjes së jetës së Bac Ademit, ka qenë më i dhimbshmi. Ende më duket e pabesueshme. Por ajo që duhet të na ngushëllojë, është edhe fakti real, që miku ynë la veprën e pavdekshme.

**Sevëme Fetiqi:** Faleminderit për postimin, mike e dashur Shpresa Krasniqi! Këtë poezi do ta lexoj shpesh. Sa vargje te bukura këto, por pas vdekjes se tij, më bëjnë vetëm të qaj dhe s´di a jetën apo vdekjen ta mallkoj që na e mori Bacin e dashur, kur ai kishte më së shumti dëshirë të jetojë. Sa vështirë po kalojnë këto ditë pa të, pa komentet e tij që na jepnin kurajo të shkruajmë edhe me shumë. I qoftë dheu i lehtë, bacës Adem!

**Marjan Dodaj:** **Lamtumirë Baca Adem!**

**Shaban Berisha:** Po po ndodhi pa prit pa kujtu. Shumë po na mugon, s'muj me marrë me mend se ma s'kam vlla. Koka veshtirë me perballu humbjen e vllait. Të gjithë miq e shokë kahdo që janë mrend e jasht nëpër botë, që e kanë dashtë vëllaun tim, ju shprehi ngushëllime, dhe familja Shaban Berisha u është mirënjohës për përkrahje dhe kurajo, zoti ju shpërbleftë, që po na i lehtësoni dhimjet për vëllaun tim.

**Shpresa Besa:** Përshkruar një biografi jetësore për z Adem Gjurgjeviku, këtij burri dhe njeriu të madh i cili punoi dhe jetoi gjithmonë me një ideal patriotik, me një dashuri të madhe për atdheun dhe njerëzit e tij ...me një përkushtim të madh shkroi edhe veprat e tij poetike të cilat i la kujtim pas vetes!...ato lexohen me shumë përkushtim nga gjithë ata që patën rastin ta njohin poetin e shquar z Adem Berishën....i lehtë i qoftë dheu i

Kosovës të cilën e deshti aq shumë!...Juve z Shaban Cakolli, Ju përgëzoj për këto vargje përkujtimi për mikun tonë të paharruar!

**Shpresa Besa:** Nderimet e mia për Ju të nderuar miq, z Skender Braka, dhe Ju i nderuari z Nehat Jahiu...njëherit Ju faleminderit për komentet e Juaja...është një fat i madh për të gjithë ata të cilët njoftën këtë burrë të madh, këtë njeri dhe mik me plot virtyte të larta njerëzore, i cili ka ditur të dhurojë vetëm dashuri dhe respekt në familje, por edhe mes miqsh....respekt për Ju.

**Fatmir Bajraj:** Ngushëlime të thella nga unë dhe familja ime Baci Shaban; për Ty dhe dhe përmes teje gjithë familjes suaj në Rahovec dhe Gjurgjevik të Madh. E ri-takofshim në parajsë Bacin Adem tonë të dashur që do të na mungojë -padyshim ! U preftë në paqe...

**Nexhat Rexhaj**: E nderuar familja e Mikut dhe njeriut të dashur e Z. Adem Berisha. Sa vështirë e pranuam lajmin për humbjen e njeriut që e deshtëm e respektuam për së gjalli. Ju lutem pranoni ngushëllimet më të sinqerta për Ademin tuaj dhe tonin. Unë ndihem keq për humbjen e mikut tim, por njëherit jam i lumtur që për disa vite u njohëm dhe komunikuam me të. Ai mbetet njeriu që na la kujtime të pashlyeshme në jetën tonë. Ai do të mbetet në kujtesën tonë përgjithmonë. Të jeni krenar për prindin, bashkëshortin dhe mikun tonë. Ai ishte i të gjithëve.

**Venka Capa:** Poeti nuk vdes. Ai është në përjetësi me engjëjt duke dhënë bekime siç bënte në jetën që bëri sa që këtu midis nesh·

**Fadil Curri:** Miku im i penës, Zotri, Xheladin, pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta për mikun tonë të penës, i cili udhëtoi për në amshim apo thënë më mirë në përjetësi! Shkrimtarët, poetët, krijuesit, janë si dëshmorët apo martirët, gjithmonë janë të pavdekshëm!!!

**Kozeta Zylo:** Bashkë me qytetin e heshtur atje në Kosovë, lotonin dhe qytezat e emigrimit, ku vargjet e tij ishin si fijëza dritash dhe pika takimesh me njerëz fisnikë si ADEM BERISHA, POETI QË S'SHUHET KURRË! Pranoni ju lutem z. Mjeku ngushëllimet e mia...

**Sabit Rrustemi:** Xhelë, e paske zbutur pikëllimin tënd dhe tonin, përmes vargjesh. Dhe, ky është ai ngushëllimi i bukur që dhembjen dëbon, e kujtesën rizgjon!

**Gëzime Sinani:** Të hënën mora librin që më kishe postuar, në të cilin ti më shkruaje: "Kujtoje Bacën Adem edhe kur të mos jetë..."E parandjeve "ikjen"? Akoma jam e shokuar dhe s’arrij ta besoj se miku, vëllai, burri i fortë, fisniku i madh, nuk ndodhet në mes nesh...

**Shpresa Besa:** Sa bukur e ke shkruar këtë përkujtim Gëzime e dashur...edhe unë i bashkohem këtij përkujtimi dhe mallëngjimi për mikun tonë të shtrenjtë z. Adem Gjurgjeviku, s'ka ditë që nuk e vizitoj faqen e këtij poeti dhe burri të madh...ka lënë përshtypje shumë të mira mes nesh, ka shpërndarë dashuri dhe mirësi pa kufi mes miqsh....të gjithëve na mungon ky shpirt i bekuar njeriu i cili iku kaq shpejt, nuk e pritëm këtë, por ja që e shkruara e të madhit Zot!...unë të përshëndes Gëzime e dashur dhe të ngushëlloj për dhimbjen dhe mallin që po ndjen për Z

Adem...sepse gjithashu jam në lëkurën tënde!...qoftë i pa harruar kujtimi për këtë burrë, baba dhe mik të nderuar!

**Gëzime Sula Sinani:** E dashur Shpresë ashtu siç mua dhe ty Bac Ademi na quante motra. Unë e ti si dhe shumë mike të tjera e ndjemë nga afër fjalën dhe dorën e tij të ngrohtë. Ishte fjala dhe kontributi i tij që unë të shihja por dhe të njihja realisht. Ai kurrë s'përtonte të ishte i pranishëm në çdo promovim libri dhe të më dërgonte telefonatën që gjendej në Tiranë. E vërtetë dhe unë vizitoj faqen e tij ashtu siç e bën ti. Ishte një zotni i rrallë ai burrë. E vërtetë që dashuria e tij s'kishte limit për të madh e për të vogël. Të falënderoj për çdo fjalë dhe germë, e dashur Shyhret. Po kjo është jeta, shpesh tinëzare për të në marrë njerëzit më të mirë dhe më të dashur. PUSHOFTË NË PAQE..Faleminderit mikja ime mirë.

**Xheladin Hamza:** Mik i dashur Xheladin Mjeku, të njëjtën dhimbje e ndamë të gjithë së bashku, dhe në njëfarë mënyre ia lehtësuam dhembjet njëri-tjetrit. Nuk ia lamë barrën vetëm njërit prej miqve. Kështu të gjithë nga një pjesë e morëm dhe e bartim me vete.

**Xheladin Mjeku:** Edhe dhimbja, edhe kujtimi për mikun janë të arsyeshme. Kujtimi për të mbetet i paharruar, por mungesa është zbraztësirë me pamje humbelle. Ngushëllimi i vetëm për të mbetet kujtimi dhe respektimi i fjalës, veprës dhe mesazhit prej atdhetari e miku të devotshëm. Dhe këtë ia kemi borxh, padyshim!

**Halil Xani:** Miku Xheladin, së pari Ju shpreh ngushëllimet e mija për mikun e shtrenjtë, të cilin dje po

e prisnim të dytë, po e priste edhe shoqëria tjetër që ishin në promovim, në Prishtinë, e së dyti të them se je mjeshtër i vargut dhe ke penën e mprehtë.

**Jetnor Llangos:** Zoti gjithmonë merr me vete para kohe njerëzit më të mirë, ata që na lëndojnë më shumë në shpirt.

**Vaid Hyzoti:** E shkruar me dashuri, nderim dhe dhimbje njerëzore...

---

**Xheladin Hamza:** E dashura dhe shumë e respektuara mike z. Suzana Zisi, në mesin tonë në ngushëllimet e familjes së tani të ndjerë Adem Berishës ishe edhe ti. Biseduam me miq, Xheladin Mjekun, Agimin, Edi Gashin dhe shumë të tjerë. Të kemi përmendur shumë herë gjatë bisedës që kishim. Andaj, konsideroj se shpirtërisht ishe prezente në mesin tonë dhe ke ndarë dhembje me të gjithë ne që jemi miq.

**Xheladin Mjeku:** Dhe do të jetoj në mesin tonë me fjalën, vargun e mesazhin që rrezaton ardhmëri. Lavdi jetës dhe veprës së tij!

**Sylejman Muriqi:** Ngushëllime familjes, shokëve, miqve dhe kolegëve! E përjetshme vepra e tij!

**Haxhi Muhaxheri:** Nga „Sofra poetike“, „Faqja për fëmijë“, „Arena“ dhe „Pena“

NGUSHLLIME FAMILJES SE ADEM GJURGJEVIKUT

Me pikëllim të thellë morëm kumtin se miku ynë shumë i respektuar, na e la lamtumirën.

Poeti dhe krijuesi i nderuar, kontribuoi vazhdimisht në faqet tona duke publikuar krijimet e tija. Ndaj, në emër te stafit të këtyre faqeve i shprehim ngushëllime familjes Berisha nga Gjurgjeviku i Klinës, kolegëve të tij krijues dhe miqve që e deshën dhe e respektuan.

Për stafin e faqeve „Sofra poetike“, „Faqja për fëmijë“, „Arena“ dhe „Pena“

**Haxhi Muhaxheri**

**Agron Adem Berisha:** I nderuari z.Xheladin Hamza, Gjurgjeviku kishte shumë burra dhe trima të njohur, në mozaikun e këtyre vlerave ky Diell u jepte ndriqim ngrohtësi dhe shkëlqim atyre, Diell pa rrezet e të cilit mbetëm edhe ne familjarët, shokët dhe miqtë e tij, faleminderit për këto vargje të mrekullueshme, këtë epitet mbresëlënës shpresoj se një ditë do ia gdhend në epitafin pranë varrit të tij .

**Shadije Hotnjani:** Gjatë do e përkujtojmë poetin e madh, mikun e ndershëm Adem Gjurgjeviku-Berisha. Na la kujtime të mira nga miqësia dhe krijimtaria. Por më në fund fatkeqësisht u nda nga jeta, familja, miqësia dhe krijimtaria. Humbi jetën tragjikisht në një aksident komunikacioni. Trupi i tij u preftë në paqe...!

**Sanije Kaqkini:** Njeriu që len pas vetes shumë MIQ, është i paVDEKSHEM, ja vlen të lotosh për një mik si POETIN E MADH ADEM BERISHEN, ZOTI e mëshiroftë me xhenet. E dashur Hasime më vjen keq për

humbjen e mikut, vetëm fizikisht, por them lum ky që të pat mike, dhe sot shkruani aq fjalë briliante për TE. TË LUMTË POETE!

**Fehmi Korca:** Ngushëllime mikja ime për bacën Adem....,

**Fehmi Berisha:** Ngushëllime për mikun, Hasime!

**Mc Dinny Ramadani:** Mooosss... Zoti e shpërbleftë me xhennet. Ngushëllime familjes. M'tronditi ky lajm :'(

**Ramadan Xhinovci:** Me keto vargje të dalura nga zemra Juaj keni bërë një nder të madh për këtë mik që e kishim e më nuk e kemi, po vetëm fizikisht nga që AI do të jetë gjithmonë pranë neve që e deshëm dhe e nderuam shumë, po në të njëjtën kohë keni nderuar edhe ai na deshi e na nderoi shumë.

**Selvete Tërstena:** Ngushëllime për mikun, Hasime! Ngushëllime i nderuar, Sabit!

**Imagjinata VS**: Sot, pikërisht sot më erdhi libri, të cilin e kishe nënshkruar dhe dërguar dje! Dje, më datë 15.05.2012. Dje, kur Ti ike në përjetësi. "Përballje"!. Titulli i këtij libri ishte. Dhe vërtetë, kur e mora këtë libër m'u dashtë të përballem me lotin, me dhimbjen, me trishtimin, me mallin, me mërzinë më të thellë që mund të ndjej për një Mik timin kaq të madh, kaq zemërbardhë, kaq Hyjnor që ishte Ti o Zot!. Unë librin e mora sot, o baca Adem, por, nuk mund ta shfletoj ende...sepse kam frikë se lotët e mi shi do t'i

lagin fletët e këtij libri që do ta ruaj si përshëndetjen e fundit me Ty nga kjo jetë...

Pusho i qetë tani pranë Diellzës tënde që aq shumë e deshe. Të qoftë i lehtë dheu i Gjurgjevikut tënd të madh, që aq shumë e deshe! O baca Adem i joni mendjendritur! Të gjithë ne që kemi origjinë nga Gjurgjeviku i Madh, krenohemi me TY!
Ngushellime Familjes Berisha,
Nga **Vlora Banushaj**,

**Rajmonda Malecka:** Bora ta ndali një çast, hapin të vije në promovimin e librit tim, në Tiranë, por erdhe aty me fjalët tua, që u lexuan me mjeshtri artistike nga drejtuesi i aktivitetit, dhe aty u ndje prezenca e shpirtit tënd të madh, pata fat të të kem mik.

**Valentina Prifti:** U prehsh në paqe dhe në qetësi, o miku ynë i madh, o burrë fisnik , o njeri i nderuar dhe respektuar. Lamtumirë!!!! Më në fund ëndrra juaj u realizua për të qenë pranë DIELLZËS; Të qoftë i lehtë dheu i Rahovecit!!!!!! Ngushëllime të sinqerta ju të gjithë familjarëve të nderuarit Z. BACË ADEMI*******

**Resmije Rrahmanaj:** I bashkohem dhimbjes së familjes Berisha. Lajm shumë i hidhur që e paskem humbë Bacën Adem. Ju preftë shpirti në xhenet. Shfrytëzoj rastin të ju shpreh ngushëllime të gjithë njerëzve të tij të dashur, miqve familjarëve dhe kush e njohu dhe e deshti. Sa njeri me zemër të mirë ishte do të na mungojë të gjithëve.

**Faruk Buzhala:** Me keqardhje kuptova se miku ynë i urtë dhe i dashur, baca Adem na la ! Shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për familjen e tij dhe të gjithë miqtë. Zoti e bekofte dhe pushofte në paqe!

**Gentian Çollaku:** Ngushëllime familjes!!

**Peso Alfonsi:** T'pastë dritë shpirti...o baca im, i urtë, e i mirë!

**Viska Hajdari:** Ngushëllime familjes, shokëve e miqve! Qoftë i përjetshëm kujtimi për TY!

**Sevëme Fetiqi:** Ende pikojnë lotët, por mendja s´dëshiron të besojë se sot do të behet varrimi i trupit tënd. Te qoftë dheu i lehtë, Bac. Na i le veprat e tua të urta dhe të mira që s´do të vdesin kurrë. Shpirtërisht kurrë s´ do të na mungosh. Do të të gjejmë në shkrimet e tua ku e le shpirtin tënd. Më fal që s´po mundem të jam në përcjelljen tënde të fundit!
Takimet e poeteshave shqiptare në Vushtrri 2010. me Alma Papamihalin dhe me bacën Adem Gjurgjeviku. Ah, sa krenar ishte atë ditë që ishte në mesin tonë, sa të lumtura ishim që e takuam për herë të parë.

**Shpresa Besa:** Të gjithë po ndjejmë dhembje, motra ime Seveme, por e di që ti mund të ndjesh më shumë, pasiqë ke kujtime më të freskëta me Bacin Adem Gjurgjeviku, pasiqë ishte në promovimin e librit tënd...jam e sigurt që Ju ka lënë mbresa dhe kujtime të paharruara.

**Gëzime Sinani:** Është e vërtetë Seveme dhe Shpresa nuk ka ngushëllim për ikjen e këtij njeriu nga kjo jetë. E këtij burri të madh që na shtriu dorën dhe fjalën e ngrohtë. Unë humba mikun tim të zemrës, njeriun që e deshi i madh dhe i vogël.

**Sevëme Fetiqi:** Ngushëllime, edhe juve motrat e mia të dashura Shpresa Besa dhe Gezime Sinani! Edhe njëherë po bindemi se asgjë më me rëndësi për njeriun nuk ka se fjala e ngrohtë, dora e ngrohtë dhe sinqeriteti. Ngushëllime të gjitha mikeve dhe miqve për humbejn e Bacit tonë!

**Fadil Demaku:** Heu baca Adem, kam menduar se do të takohemi edhe njëherë së pakut para se të shkoje te Djellëza, që aq shumë lot derdhe për të!...
Lavdi të qoftë për jetë e mot!
Sa i afërt, i ëmbël dhe i dashur për të gjithë ishe!

**Muhamet Hoxhaj:** **Kujtimi për ty do të mbetet i përjetshëm-Adem Berisha.**
Gjatë pushimeve të verës në Kosovë, në Vitin 2010, vizitova edhe Bac Adem Gjurgjevikun Berishën në Rahovec. Nuk i lajmërova se po shkoj, po qëllimin e një surprize të veçantë ia arrita kur e takova. Takova një burrë bujar, familjar dhe poet i veçantë. Me Bacën Adem, kaluam disa orë së bashku, ku biseduam rreth librave të tij, mbesës Diellzës që shpirti i tij vuante për të. Po edhe për projektet e tij për botime të reja, ku më lexoi shumë poezi me stil artistik. Ishte i veçantë. I ndjeri m'i dhuroi dy libra: 1. Lulja e la Lulishten "Vrushkuj Elegjik" dhe 2. Krenaria dhe Pikëllimi "Poezi"

Librat mund t'i lexoni në lidhjet më poshtë. *http://www.kosovarimedia.com/index.php/biblioteka/libra-shqip1/106-lulja-la-lulishten-vrushkuj-elegjik-adem-berisha.html*
*http://www.kosovarimedia.com/index.php/biblioteka/libra-shqip1/121-krenaria-dhe-pikellimi-poezi-adem-berisha.html*
Baca Adem, ishte njëri ndër të parët që kontriboi edhe në portalin tonë informativ Kombëtar.
Në një kohë, do të shkruajmë më gjerësisht për këtë takim. Shpirti i tij u preftë në paqe.
Ke qenë dhe do të mbetesh i veçant për mua Bacë. Kujtimi për ty do të mbetet i përjetshëm.

**Mustafë Shabani:** Sa fort më tmerroi ky lajm tragjik. Sa e vështirë është të kapërdihet diçka e tillë, dhe mua më mungojnë fjalët në këto çaste. Po mjerisht sot jemi para një fakti të dhimbshëm dhe të padurueshëm, para një fakti ku engjëjt po ikun nga kjo botë, e cila vërtetë është bërë e pistë. Të tillë e kanë bërë hajdutë dhe kriminelë, të cilëve mjerisht nuk po u vije fundi. Pse o Zot na i merr ata që na duhen, e na i shton të tillë, që prishin dhe dëmtojnë atë që na e dhurove o krijuesi ynë? Unë lutem për mikun tim-tonë, për shpirtin e tij prej engjëlli. O Zot i madh ndihmoj familjen e tij në këto çaste të vështira. Ngushëllimet e mia më të thella për familjen, miqtë dhe rrethin, për këtë humbje kaq të madhe për kombin.

**Shpresa Besa:** Sa vonë qenkam kyqur për të kuptuar këtë lajm kaq të dhimbshem të cilin aspak nuk mundem ta pranoj...Jo jo nuk mund ta pranoj se kemi humbur një mik kaq të mirë, një njeri kaq madhështor, një burre kaq të fortë me tipare të mrekullueshme pozitive që rrallë

ndonjë njeri në këtë botë mund t'i ketë. Unë e njofta shumë mirë, meqë u takuam në Tiranë. Aty edhe shkëmbyem biseda nga më të ndryshmet. Dhimbja e tij e madhe për Diellzën e vogël kishte hapur plagë të mëdha në zemren e Tij...dhe lotët rridhnin pa pushuar nga sytë e Tij të përmalluar...Nuk e kam menduar se kjo dhimbje edhe do t'i shkaktoje nje vdekje kaq te hershme...sepse Ai ishte nje burre shum i forte , mbante qendrim dinjitoz dhe ngushllonte te tjeret per te mos u dorezuar lehte dhimbjes se humbjeve ...por...Jeta qenka genjeshtare...te tradheton mu ne kohen kur me se paku e pret...ngushllimet me te sinqerta per familjen e z Adem Gjurgjeviku...kurre mos u harrofte kujtimi per kete njeri te madh...i lehte i qofte dheu i Kosves.

**Alma Papamihali:** "Për të dashur njëri-tjetrin, nuk është e thënë të na ketë lindur e njëjta nënë" Nuk janë fjalët e mia, por shprehja e fundit dje në FB, shkruar nga miku yne z. Adem Gjurgjeviku, i cili ndërroi jetë aksidentalisht sot, në këtë ditë Maji. Një lajm që më trishtoi pa masë…ndër të tjera, kur pikërisht sot, më mbërriti në postë dhe libri i tij i fundit, me një përkushtim miqësor. Ky lajm më bindi më tej, që jeta është kontradiktore, madje edhe një ditë e vetme mund të jetë e tillë. Ndërkohë që doja ta falenderoj për librin, (madje dhe një poezi të dedikuar në të), dëgjoj këtë lajm te trishtuar. Doja t´i shpreh mirënjohjen për dashamirësinë, ta falenderoj, t´i uroj shëndet dhe suksese në vazhdimësi, por nuk munda të bëj asnjërën prej urimeve që doja. Ndihem e trishtuar që më duhet të jap ngushëllimin tim, që shpirti yt xha Adem, të prehet në paqe…dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe, sepse shpirti i tij ishte paqësor, i dashur, një shëmbëlltyrë e vertetë e

atdhetarizmit. Ne panairet letrare, gjthashtu ka qene gjithnje i pranishëm, mes miqve dhe krijuesve. Nuk kam fjalë :(( Ngushëllime familjareve. Një prind, një gjysh, një mik që la pas vetëm figurën e një njeriu pozitiv. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

**Gëzime Sula Sinani:** Unë asnjëherë s'harroja të përshendesja fundjavën ty miku im me lulet e bardha. Gjithmonë merrja bekimin tënd. Ti dije të falënderoje dhe të shkruaje aq bukur, sa unë mallëngjehesha nga fisnikëria jote. Ishe dhe mbete për mua simboli i Burrit të Madh me zemrën e artë flori. Të kujtoj shpesh me familjen, sepse unë të njoha me ta dhe ata si unë ruajnë në zemër Bacën Adem. Ti u gdhende në përjetësi me fjalën dhe dorën e ngrohtë tënde. Isha e lumtur që njoha një njeri si ti. Pushofsh në paqe miku im. Më mungon...I paharrueshëm kujtimi yt, Burri i Madh i Kosovës.

**Xheladin Mjeku:** Për asnjë çast nuk mund të thuhet me fjalë ajo që është thënë me shpirtin që pikonte dhimbje. Krenohemi që e kishim këtë mik bujar, vepra e të cilit na bën të fortë dhe na obligon ta kujtojmë dhe respektojmë për sinqeritetin që rrezatonte tek të gjithë ne.

**Leonard Qyteza:** **Diçka Postmortum.**

I lindur e i vdekur në Maj, i dashur dhe i qeshur me të gjithë, trim e bujar, i thyeshëm për mbesën, deri në vaj, poet dhe misionar,.....të falemi për miqësinë që na ke lënë.
Faksimilen e dedikimit tënd, po ta dërgoj si kurorë dhe si lamtumirë, o Bacë!

**Ema Imeri:** "Kur poeti i mbyll sytë edhe vargjet qajnë!"
Gjithmonë i pavdekshëm kujtimi për ty baca Adem Gjurgjeviku, miku ynë i nderuar!
Ngushëllime familjes Berisha dhe t'gjithë dashamirëve të bacës Adem!
Zoti ua lehtësoftë dhimbjen e mërzisë!

**Ali Dula:** Sa u takuam para ca ditësh një mbrëmje poetike dhe i thamë si pak në shaka që për mrekulli po rinohet ! E baci Adem si githnjë i hapur për komunikim miqësor e pranoi me buzëqeshje e na falendëroi. Ngushëllime më të sinqerta familjes së bacit Adem, kurse atij i qoftë i lehtë dheu i Kosovës sonë, që aq shumë e deshi baci ynë dhe aq shumë shkruajti dhe veproi për të. Perëndia e Lartësuar për të gjitha veprat e mira e shpërbleftë me parajsën e bukur, e për ndonjë lëshim, e lehtësoftë!

**Jahë Jusufi:** Tani sapo mora vesh se miku im dhe ish shoku im i normales z.Adem Berisha paska ndërrruar jetë! U pikëllova ! Sa njeri i madh që ishte . Kishte një zemër të një patrioti e të njeriu për njeriun që nuk do të harrohet ! I lehtë i qoftë dheu ! Ju familje e nderuar Ju shpreh ngushëllimet e sinqerta !

**Spiro Naqo:** I dashuri dhe i shtrenjti Adem GJURGJEVIKU, nuk do të jetë më mes nesh....!! Është vërtet një lajm shumë tronditës! Miku ynë i paharruar Adem, ka lënë mbresa të pashlyeshme, për mënçurinë, thjeshtësinë e komunikimit, fisnikërinë e një burri të urtë...!!! I paharruar dhe i përjetshëm qoftë kujtimi i

Ademit të dashur! U prehtë në paqe, shpirti i pastër i këtij atdhetari të shquar! I lehtë i qoftë dheu, që do ta mbajë në përjetësi!
Ngushëllime të përzemërta, familjes së të ndierit!

**<u>Teuta Shala Qyteza:</u> Një mik i dashur na la...!!!**

Shpreh dhimbjen dhe keqardhjen time më të thellë për humbjen aksidentale të jetes, nga miku ynë i dashur, Bacë Adem Gjurgjeviku!!
Kam kaq kohë që e lexoj krijimtarinë e Tij, që e takoj nëpër aktivitete letrare, që këmbejmë mesazhe miqësore dhe deri pak ditë më parë, kur në shtëpi na mbërriti libri i Tij i fundit "Përballje".
Sonte, gjyshi prehet bashkë me Diellzën e dashur... mbesën e munguar prej kohësh, të cilën na e afroi dhe na e bëri tonën, me anë të poezive kushtuar engjëllit të vogël!!
Me shpirt e zemër të dridhur, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të Bacës... zonjës Gjurgjeviku, fëmijëve, nipërve e mbesave, por edhe miqve tanë të përbashkët, të cilët ndjehen si unë sonte...
Nuk do ta harrojmë Bacë Ademin!! Na ka lënë kujtime të vyera, biles me dedikimin "për ta kujtuar kur të mos ishte më!!" Po pse kaq shpejt, o Bacë...??!!
*
I lutem familjarëve të Tij, të mos e mbyllin faqen e Facebook-ut ... Të na e lënë si një dritare të hapur, ku do marrim akoma kënaqësi prej Emrit e shkrimeve të Tij!!
Pushoftë në paqe dhe i përjetshëm i qoftë kujtimi!!
Me dhimbje e respekt, Teuta.

**Leonard Qyteza:** Pushoftë në paqe!

**Lili Bimi:** Baca Adem përse ike nga ne? U bëre engjëll dhe na le neve këtu? Mos vallë mbesa yte e dashur Djellëza kaq shumë të mungonte sa ike dhe fluturove drejt saj. Përse Baca Adem ...Përse? Ne ishim shumë që të donim, po prisnim librin tënd. Më premtove që do takohemi në verë, por nuk e mbajte premtimin, ike ike, pa asnjë përshëndetje Baca Ynë. Do na mungosh por dije që do jesh në zemrat tona. Lamtuirë Baca Adem! Ehhhhh, lotët e mi nuk pushojnë... Ngushëllimet e mia Zonjës Qerime, vajzave, djemve, nipave dhe mbesave ...O baca Adem, të qoftë i lehtë dheu i Kosovës. Zoti e shpërbleftë me vendin më të bukur në parajsë.

**Gani Orana:** Sot e mora një lajm të zi nga larg për Vëllaun, Mikun, Poetin tone, Adem Berishën një lajm tragjik që nuk po mund ta marr me mend ende, se na iku nga kjo botë njeriu i penës që ne ende kishim nevojë...Unë i lutem Zotit që në këto momente ta ndihmoj familjen e tij në këto çaste të vështira që po kalon që sa do pak ta ndajmë këtë dhimbje. I qoftë i lehtë dheu i tokës arbërore

**Vera Kurti:** JETA ËSHTË VETËM NJË FRYMËMARRJE DHE FRYM{NXJERRJE, NJË PSHERETIMË!
Adem Gjurgjeviku, ADEM BERISHA apo BACË ADEMI siç e thërrisnim, ndahet sot nga jeta e tij aksidentalisht..! Se ç'humbje është për familjen e tij, no comment..:((( Ne miqtë e tij humbëm njeriun SIMBOL të MIRËSISË dhe DASHAMIRËSISË! Nuk do të them fjalë të bukura siç rëndom bëhet kur dikush

ndahet nga kjo jetë, pasi për BACË ADEMIN nuk reshtën fjalët e mira sa qe gjallë pasi i tillë qe! E PABESUESHME! E mori DJELLËZA, mbesa e tij që shihni në këtë foto, humbja e së cilës e tronditi aq shumë sa, ai nuk pati qetësi e rehati në këtë jetë! Bekuar shpirti juaj BACë ADEM! Në kujtesën time gjatë do të mbetet emri dhe mirësia që ju shpërndanit kudo..!

**Agron Adem Berisha:** Ditët po kalojnë pa ty ndërsa dhembja sa vjen dhe shtohet, hija e jote i dashur Baba, vazhdon të qendrojë nëpër shtepi, akoma çdo e hapur e derës më bën të ngre kokën lart e të shpresoj se do të shoh ashtu të buzëqeshur, çdo mbrëmje pres deri vonë i zgjuar që të na urosh natë të mirë, por jo si duket ditët e lumtura me ty tani kanë ikur dhe ato kanë mbetur vetëm në kujtime të ëmbla të cilat kurrë nuk do i harrojmë. Prehu në paqe dhe në qetësi o i dashur Baba!

**Shpresa Besa:** Agron i nderuar e di që është dhimbje e madhe të humbësh babanë, por të humbësh një baba të tillë siç ka qenë babi Juaj, është shumherë më dhimbje dhe vuajtje...do ta keni shumë të vështirë të mësoheni pa praninë e Tij...por duhet pajtuar me atë çfarë ka zgjedhur i madhi Zot...z Adem Gjurgjeviku, ndjesë pastë ka shkuar tashmë te engjellusha e saj Diellëza, për të cilën vuajti aq shumë....Juve Ju uroj të bëheni të fortë e të përballoni këtë dhimbje të madhe duke e mbajtur gjithmonë në kujtesën tuaj ashtu të mirë siç edhe ishte!...

**Mejreme Gjocaj:** **LAVDI**

Ende është e pabesueshme që jetojmë pa ty, sepse në çdo bisedë, në çdo kohë në çdo mjedis na duket sikur të kemi pranë, sikur t‘i shohim sytë, sikur ta dëgjojmë zërin. Kujtimet për ty mbeten gjithmonë të dashura e të freskëta për ne. Në qiell u shtua edhe një engjëll, duke na lënë përgjithmonë të pikëlluar. Mungesën tënde po e ndiejmë në zemrat tona. Zoti ju bekoftë në parajsë.

# IV
# ALBUM
# I VEÇUAR

**ADEM BERISHA – GJURGJEVIKU**
**(1948 – 2012)**

**Ishte komunikativ dhe i dashur për miqtë**

**Me bashkëshorten Qerimen**

**Në mesin familjar**



**Me Djellzën**

**Gjithmonë ishte i dashur për të gjitha brezat**

**Çaste përkujtimi**

**Me Skender Brakën**

**Me Arqile Gjatën**

**Kolec Traboini, Myrteza Mara, Fatime Kulli, Lisiana Demiraj dhe Teuta Gjata**

**Me Margarita Xhepën**

**Me Teuta Shala-Qyteza**

**Me Suzana Zisin, Kozeta Zavalanin, Raimonda Moisiu Xheladin Hamzën, Nexhat Rexhën, Sarë Gjergjin etj.**

**Me Alma Papamihalin dhe Gëzime Sinanin, në promovimin e librit "Aromë gruaje"**

**Sevëme Fetiqi dhe Mimoza Sali -TPK-Vushtrri-2011**

**Me Suzana Zisin, gjatë promovimit të librit të saj**

**Me Halil Xanin dhe miq të tjerë**

**Gjatë një aktiviteti letrar- Egla Imeraj lexon një poezi të Adem Berishës**

**Me Skender Korçën**

**Me kolegun e punës dhe të penës Xheladin Hamzën**

**Me Kozeta Zavalanin dhe Lisiana Demirajn**

**Gëzime Sinani pas marrjes së librit të A. Berishës**

**Me Ramadan Musliun dhe Nexhat Rexhën**

**Me Miradije Ramiqin, Sabit Rrustemin, Sevëme Fetiqin, Nehat Jahiun dhe Xheladin Mjekun**

Xheladin Hamza dhe Bruna…

Me Xheladin Mjekun, Linditë Ramushin, etj.
pas përurimit të librit të Sevëme Fetiqit



Adem Berisha

PËRBALLJE

Poezi

Mijëra të mi të shtrenjtë zonj.
Kozeta e Qemal Zyto me
shoqërinë tënjëjtë dhe respekt-
ë-të veçantë, iu dhuroj këtë
libër si kujtim modest.
Kujto xha xhën Adem edhe
atëherë kur nuk do të jem.
Rahovec
02 maj 2012

SHTËPIA BOTUESE - SHTYPSHKRONJA
"B E R A T I" - PRIZREN, 2012

**Njëra ndër shumë dërgesat e librit "Përballje" gjithandej tek miqtë e tij**




**Ballinat e librave të botuara: "Krenaria dhe pikëllimi", "Lulja la lulishten" dhe "Përballje"**

# PËRMBAJTJA

**Xheladin Mjeku**: Prekja e pikëllimit..……..……...…5
Miqtë për mikun …….....…7

I. JETA DHE VEPRIMTARIA
Adem Berisha - Gjurgjeviku……..….11
**Fetah Berisha**: Disa fjalë për autorin ……..……..……15
Parathënja e autorit-I ……..19
Parathënja e autorit-II ……...…….....24
**Ramadan Musliu**: Në botën e ndjenjave sublime …...29
**Xheladin Mjeku**: Sprovat e jetës si frymëzim lirik…...36

II. PËRKUSHTIME POETIKE
**Adem Zaplluzha**: Miku im i fjalës ……...45
**Agim Gashi-Drenica:** Takimi na ngeli peng ...…….....46
**Agim Metbala**: Emblemë kohe …….....47
**Agron A. Berisha**: Diellzës dhe babushit të dashur …..48
**Ardit Berisha**: Babush…po ti pse ike??? …….49
**Artan Almeta**: Një miku! …….51
**Besmire Bytyçi**: Kujtimi që s'vdes ……...52
**Besnik Ceci**: Lutja e fundit-Më fal Bacë Ademi! .....54
**Besnike Dervisholli**: Mos qani për poetin ……....55
**Briliana Sharova**: Sot jemi…, po nesër!?? …….....56
**Drita Krasniqi:** Lajm i zi e mori dhenë ……...57
**Enxhi Krasniqi-Bardhaj**: Për ty Baca Adem ……..59
**Fahrije Krasniqi-Kllokoqi**: Një lis ra ……..……60

**Faton Mehmeti:** In memoriam ……61
**Gentjana Avdiaj**: Pa titull ……62
**Halil Xani**: Mikut tim Adem Mikmirit ……..…63
**Hasime Hoti**: Lajmi i zi ……....64
**Haxhi Muhaxheri**: Ka ardhur poeti ……....….66
**Imri Trena:** Biseda me lot ……67
**Ismet Tahiraj**: Baca Adem Berisha ……..68
**Izet Abdyli:** Adem miku shpirt poeti……69
**Lavdim Dushi**: Lamtumirë Baca Adem ……....70
**Lili Bimi**: Kurrë nuk vdes Baca Adem!! ……...71
**Mentor Thaqi**: Për lotin, më fal o Bacë! …….....72
**Merita Lulaj**: Dhimbja s'ka mëshirë ……75
**Milazim Kajtazi**: Trungu i Gjurgjevikut ……..…....76
**Miradie F.Avdullahi**: Bacë, të thërras unë nga Mirësia77
Për ditëlindjen tënde ……..……79
**Musa Jupolli:** Baladë në kohë ……..80
**Myrteza Mara**: Kur ikin poetët ……..…..81
**Ramadan Xhinovci:** T'pata mik e vëlla Adem ……82
**Riza Çato**: Ngele bir i perëndisë ..……85
**Sabit Rrustemi**: Pasuri e pasosshme …….…...87
**Sevëme Fetiqi**: Pa titull …….....…89
**Skender Braka**: Melodi të përgjakura këngësh ……....90
**Suzana Zisi**: baca im, Adem Berisha ……..…..91
**Shaban Cakolli**: Je bërë dritë, rrugëton me ne …….94
**Shadije Hotnjani**: Mbetëm peng i një malli …….....97
**Shyhrete Ahma**: Dhimbje ……..…….98
Edhe kur më nuk je!!! ……..……..99
**Tonin Nikolli**: S'kam lotë ……...100
**Vera Kurti:** Pa titull ……...101
**Viktoria Xhako**: Diçka do t'u mungojë agimeve …...102
**Viola B. Zogu**: Jo kjo nuk është e drejt!!!.....103
Për Ty!!! .....104
**Xheladin Hamza**: Kushtuar Adem Berishës …….....105
A të dhemb shpirti miku im .....106

**Xheneta I. Jetishi**: Ngushëllim për veten! ……107
**Xhevahir Gjonaj**:Lamtumirë miku im Adem Berisha109
**Ymer Berisha**: Lisi i madh i Gjurgjevikut ……..110
**Anonime**: Dielli i Gjurgjevikut ……..…….....112

III. HOMAZHE DHE KUJTIME
**Fatmir Terziu:** Një fjalë për dhimbjen ……..…….115
**Keze(Kozeta) Zylo**: Lamtumirë poetit të Kosovës!.....116
**Murat Gecaj:** "Monument letrar" për Adem Berishën – Gjurgjeviku ……..……....120
**Shaban Cakolli**: Lotët e një ndarjeje…….....123
**Xheladin Mjeku:** Krenohemi me virtytet atdhetare dhe veprën tënde …….....129
Pikëtakimi elektronik ……...132
IV. ALBUM I VEÇUAR …….157

# FALËNDERIM

Inisiativës për realizimin e kësaj Përmbledhjeje shkrimesh monografike, poezish dhe materialit tjetër që e identifikon punën dhe veprimtarinë krijuese të Adem Berishës-Gjurgjevikut, iu përgjigjën miq e dashamirë nga vendi e diaspora, të cilët shprehën vullnetin e tyre që të përkrahin materialisht botimin e saj.

Në botimin e librit kontribuan materialisht, përveç familjes së Adem Berishës edhe:

1. Shaban Cakolli
2. Agim Gashi - Drenica
3. Mentor Thaçi
4. Milazim Kajtazi

Të gjithë këta kontribues i falënderojmë përzemërsisht për vullnetin dhe kontributin e dhënë për botimin e këtij libri.

"Falënderojmë në mënyrë të veçantë për punën dhe kontributin e palodhshëm z.Xheladin Mjekun dhe z.Halil Xanin " – shprehin falënderimin familja e Adem Berishës, në shenjë respekti për angazhimet e hartuesve të kësaj monografie.

# PREKJA E PIKËLLIMIT

Monografi, poezi dhe përkujtime

Përgatitur nga:
Xheladin Mjeku
&
Halil Xani

Shtypi:
Shtypshkronja "Lena Grafik" – Prishtinë, 2013

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1
821.18-94
929(496.51)Berisha, Adem

Prekja e pikëllimit: monografi, poezi dhe përkujtime / Përgatitur nga Xheladin Mjeku,Halil Xani. - Prishtinë: Olymp, 2013. - 179 f. : ilustr. ; 21 cm. – (Biblioteka Monografi-Kujtime)

1. Mjeku, Xheladin 2. Xani, Halil

**ISBN 978-9951-635-07-3**